

ERA e Ngecjes

—
Maj 2018



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES



GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE **ooogapoo**



legalpoliticalstudies.org

institutigap.org

pips-ks.org

Shënim Politikash 03/2018

ERA e Ngecjes

Autoret: Albana Merja* Delfinë Elshani **

Monitoruar nga: Njomza Mjeku***

Maj 2018

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Maj, 2018.

Opinionet e shprehura në këtë dokument jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e Grupit për Studime Juridike dhe Politike, Institutit GAP apo Institutit të Prishtinës për Studime Politike, donatorët e këshillit, stafit të tyre, apo anëtarëve të bordit. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo përdoret në çfarëdo forme pa leje paraprake. Për kërkesa të kësaj natyre kontaktoni zyrën administrative të Grupit për Studime Juridike dhe Politike.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike

“Rexhep Luci” rruga 16/1

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.legalpoliticalstudies.org

E-mail: office@legalpoliticalstudies.org

Tel/fax.: +381 38 234 456

Instituti GAP

“Sejdi Kryeziu” rruga 4/2

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.institutigap.org

E-mail: info@institutigap.org

Tel/fax.: +381 38 609 339

Instituti i Prishtinës për Studime Politike

“Rexhep Luci” rruga 15/5

Prishtina 10 000,

Webfaqja: www.pips-ks.org

E-mail: info@pips-ks.org

Tel/fax.: +381 38 224 577

* Hulamtuese, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

** Hulamtuese, Grupi për Studime Juridike dhe Politike

*** Asistente për projekte, Grupi për Studime Juridike dhe Politike



Embassy of the
Kingdom of the Netherlands

Ky publikim është pjesë e projektit me titull “Mekanizmi i Monitorimit të Agjendës për Reforma Evropiane”, që financohet nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Kosovë, dhe implementohet nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Instituti GAP, dhe Instituti i Prishtinës për Studime Politike.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

ERA E NGE CJES

Hyrje

Qeveria e Kosovës dhe Komisioni Evropian kanë filluar dialogun e nivelit të lartë, i cili kulmoi me hartimin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA), për të përkrahur dhe përshpejtuar zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (MSA). Kjo e fundit është marrëdhënie kontraktuale në mes Bashkimit Evropian (BE) dhe shteteve që synojnë anëtarësimin në BE në kuadër të Procesit të Stabilizim Asocimit. Me nënshkrimin e MSA-së, Kosova është pajtuar të zbatojë një varg reformash, duke filluar nga dialogu politik, rritja e bashkëpunimit rajonal, përafrimi i legjislacionit kombëtar me Acquis communautaire, si dhe me lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit.¹ Përvojat e vendeve tjera të Ballkanit kanë treguar se zbatimi i MSA-së është gjithmonë shumë sfidues. Prandaj, ERA është hartuar me qëllim të dhënies prioritet reformave kyçe që duhen zbatuar para fundit të vitit 2017. Për më tepër, qeveria ka hartuar gjithashtu një Program për Reforma në Ekonomi (PRE) i cili synohet që të zbatohet paralelisht. Që të dy veprimet (ERA dhe PRE) do të shërbenin si udhërrëfyes për integrim evropian.

ERA përqendrohet në tri fusha kryesore, Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit, Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve dhe Punësimi dhe Arsimi. Këto përmbajnë masa dhe objektiva të caktuara për t'u përmbushur brenda vitit 2017, të prezantuara në Planin e Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve Kyçe.²

Qëllimi i këtij shënimi politikash është të vlerësojë efikasitetin dhe efektshmërinë e institucioneve gjatë procesit të zbatimit duke ofruar përqindje të caktuara për secilën shtyllë të cekur në Planin e Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve Kyçe. Në mënyrë që në fund të vitit 2017 të kemi një përshkrim të qartë të të arriturave të tyre, kemi monitoruar me kujdes punën e secilit institucion. Të gjitha të dhënat e mbledhura dhe analizuar janë pasqyruar në matricë (Aneksi 1) i cili pasqyron prioritetet dhe objektivat, si dhe afatin kohor dhe institucionin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Metodologjia

Kosova është zotuar që, deri në fund të vitit 2017, t'i përmbush të gjitha obligimet që dalin nga Planin e Veprimit të ERA - së. Ne kemi monitoruar zbatimin e këtyre prioritetëve në mënyrë që të ofrojë një vështrim dhe vlerësim mbi progresin e institucioneve drejt arritjes adekuate të qëllimeve të përcaktuara. Për ta bërë këtë, kemi hartuar një matricë në bazë të Planit të Veprimit e cila përshkruan se cilat masa apo veprime janë arritur, nuk janë arritur apo janë arritur pjesërisht. Institucioneve u jemi qasur përmes emailit, telefonit apo përmes takimeve ballë-për-ballë në mënyrë që të marrim informata lidhur me zbatimin e masave në sektorët përkatës dhe për të identifikuar sfidat, dështimet dhe arritjet kryesore. Më saktësisht, në institucionet e monitoruara brenda sektorit të Qeverisjes së Mirë dhe Sundimit të Ligjit bëjnë pjesë Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Administrimit Publik, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe, ndër të tjera, Ministria e Financave.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kosovare e

¹ Marrëveshja e Stabilizim Asocimit Ndërmejt Republikës së Kosovës, në njërin anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në nënën njetër. Bruksel 2015.

I disponueshëm në: <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-10728-2015-REV-1/en/pdf>

² Agjenda për Reforma Evropiane (ARE) (2016) Kosovë – BE Dialogu i Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe. Prishtinë. I disponueshëm në: <https://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf>

Statistikave dhe Ministria e Financave ishin institucionet kryesore të monitoruara brenda shtyllës së dytë.

Në fund, institucionet e monitoruara në shtyllën e Punësimit dhe Arsimit ishin Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Agjencia e Punësimit. Lidhur me këtë, në raste kur institucioni përgjegjës nuk ka ofruar asnjë të dhënë, këto veprime janë kategorizuar si 'nuk është ofruar asnjë e dhënë' për të pasqyruar një vlerësim të saktë dhe transparent të tërë procesit. Veç kësaj, pasi që kemi pranuar të gjitha informatat, kemi analizuar me kujdes tri aspekte kryesore, a) nëse janë përmbushur objektivat, b) nëse ato janë përmbushur brenda afatit kohor, dhe c) nëse masat ishin në përputhje me Acquis communautaire.

Gjendja aktuale

Kjo pjesë ofron dhe analizon rezultatet e arritura lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit të Prioriteteve Kyçe që dalin nga ERA. Bazuar në procesin e vlerësimit dhe monitorimit kemi parë mungesë të përkushtimit të shumicës së institucioneve në përmbushjen e objektivave të caktuara për lehtësimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Kjo nënkupton që në dy vitet e fundit Kosova nuk ka arritur ta mbajë hapin me integrimet evropiane, siç është sqaruar në vijim.

Së pari, Qeverisja e Mirë dhe Sundimi i Ligjit përbëhet nga 9 prioritete për të cilat do duhej të ndërmerren 25 veprime për ta përmirësuar gjendjen aktuale. Kjo shtyllë përqendrohet në reforma të cilat do ta mundësojnë konsolidimin në sistemin e drejtësisë dhe do ta rrisin transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë dhe zyrtarëve të saj. Përveç kësaj, reformat do duhej të ofronin rezultate më të mira në luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe, ndër të tjera, do të përfshinin miratimin e legjislacionit përmes një procesi transparent, efikas dhe të drejtë.³

Në bazë të monitorimit tanë, kjo shtyllë ka shkallën më të lartë të arritjes, ndonëse ajo konsiderohet të jetë një nga shtyllat më sfiduese dhe më problematike. Më saktësisht, 68.6 për qind të objektivave janë arritur me sukses, 20 për qind janë arritur pjesërisht dhe 11.4 për qind nuk janë arritur. Mungesa në zbatimin e prioriteteve në këtë fushë ka të bëjë kryesisht me hartimin dhe miratimin e kornizës legjislative, d.m.th. Ligji për Shërbimin Civil, Ligji për Pagat, apo Ligji për Organizimin e Administratës Shtetërore. Së dyti, Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve përbëhet nga 7 prioritete të cilat përfshijnë 75 veprime konkrete. Për ta përmirësuar këtë sektor, institucionet duhet të përqendrohen në ndërmarrjen e reformave të rëndësishme për të promovuar investimet e drejtpërdrejta të huaja, përmirësuar mjedisin biznesor, luftuar ekonominë joformale, mbështetur zhvillimin e NVM-ve dhe ngritur lidhjet rajonale.⁴ Përveç kësaj, institucionet duhet t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të përmirësuar bazën e prodhimit dhe për të zhvilluar kapacitetet për eksport.

Rezultatet nga monitorimi tregojnë se 32.9 për qind e prioriteteve ishin arritur deri në fund të vitit 2017. Për më tepër, 53.7 për qind janë zbatuar pjesërisht, ndërsa 13.4 për qind nuk ishin përmbushur. Ngjashëm me shtyllën e parë, pjesa më sfiduese ishte lidhur me hartimin dhe miratimin e ligjeve të ndryshme të dedikuara për

³ Agjenda për Reforma Evropian (ARE) (2016) Kosovë – BE Dialogu i Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe. Prishtinë. I disponueshëm në: [https:// http://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf](https://http://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf)

⁴ Agjenda për Reforma Evropian (ARE) (2016) Kosovë – BE Dialogu i Nivelit të Lartë për Prioritetet Kyçe. Prishtinë. I disponueshëm në: [https:// http://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf](https://http://www.mei-ks.net/repository/docs/erafinalsq.pdf)

përmirësimin e klimës së biznesit. Më hollësisht, institucionet nuk kanë arritur të hartojnë dhe miratojnë disa nisma legislative, siç është Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim; legjislacioni dytësor i Ligjit për Organizatat Biznesore; Ligji për Inspektimet e Përgjithshme, Ligji për Bankat, Institucionet Mikro-financiare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare.

Në fund, por jo për nga rëndësia, Punësimi dhe Arsimi përfshinë 6 prioritetet kryesore të cilat përqendrohen në përmirësimin e kushteve të punësimit dhe mundësive veçanërisht për femrat dhe gjeneratat e reja, përmirësimin e cilësisë së arsimit përmes zbatimit të kurrikulës së re, ofrimit të programeve më të mira për aftësimin e mësimdhënësve dhe aftësimin profesional të cilësisë më të lartë. Përveç kësaj, është konsideruar tejet i rëndësishëm përpilimi i reformave të cilat kanë për qëllim ngritjen vijueshmërisë në klasat parashkollore dhe forcimin e lidhjes në mes arsimit të lartë dhe tregut të punës. Gjithsej 31 veprime konkrete duhet të ndërmerren për t'i përmbushur të gjitha objektivat që rrjedhin nga kjo shtyllë.⁵

Në këtë shtyllë, shkalla e zbatimit ka qenë më e ulëta nga të tri shtyllat. Më saktësisht, në fund të vitit 2017 vetëm 21.9 për qind e objektivave ishin arritur, 59.4 për qind ishin zbatuar pjesërisht dhe 18.7 për qind prej tyre nuk ishin zbatuar fare. Problemet kryesore në këtë fushë kishin të bënin me themelimin dhe funksionimin e Agjencisë për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim, përmirësimin e cilësisë Arsimit dhe Aftësimin Profesional (AAP) dhe rishikimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit. Veç kësaj, qeveria duhet të ndërmarrë politika për ta forcuar lidhjen ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës.

Për ta përmbledhur, rezultatet e përgjithshme të monitorimit sugjerojnë që institucionet kosovare kanë arritur t'i përmbushin vetëm 38.9 për qind të objektivave të parapara për t'u përmbushur gjatë vitit. Veç kësaj, 47 për qind ishin përmbushur pjesërisht, ndërsa 14.1 për qind të objektivave nuk ishin arritur. Siç u shtjellua më lartë, rezultatet e secilës shtyllë sugjerojnë që institucionet që kanë të bëjnë me sektorin e Qeverisjes së Mirë dhe Sundimit të Ligjit, janë treguar më të suksesshme në arritjen e objektivave, të cilat ndiqen nga Konkurrueshmëria dhe Klima e Investimeve dhe tek pastaj ato që kanë të bëjnë me sektorin e Punësimit dhe Arsimit.

⁵ Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) (2016) Kosovë - Dialogu i Nivelit të Lartë të BE-së mbi Prioritetet Kryesore. Prishtinë. I disponueshëm në: https://www.mei-ks.net/repository/docs/era_final.pdf

Përfundim

Agjenda për Reforma Evropiane ishte lansuar si dialog i nivelit të lartë në mes BE-së dhe Kosovës në mënyrë që ta përshpejtojë zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit. Zbatimi i ERA - së ka filluar në nëntor 2016 me qëllim që të ndërmerren të gjitha reformat e përcaktuara me Planin e Veprimit brenda vitit 2017. Duhet cekur se ky proces thelbësor ishte neglizhuar me të madhe nga të dy qeveritë, Mustafa dhe Haradinaj, të cilat u përqendruan në kalendarin e ngjeshur zgjedhor, meqë u zhvilluan si zgjedhjet e përgjithshme ashtu edhe ato lokale. Ndonëse qeveria Mustafa tregoi një entuziazëm të lartë në lansimin e këtij procesi, zbatimi i tij në gjashtë muajt e parë dështoi t'i përmbushë pritshmëritë e të gjithëve. U supozua se qeveria Haradinaj do t'i jepte prioritet zbatimit të ERA-së dhe të përfshijë reformat përkatëse në programin e ri qeverisës; megjithatë, si paraardhësi i tij, ai zgjodhi strategjinë 'prit dhe shih'.

Procesi i monitorimit vërteton se qeveria e re nuk ka treguar ndonjë përkushtim të qartë për të ndërmarrë reformat e nevojshme të theksuara në ERA, që në mënyrë adekuate ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, përmirësojë mjedisin biznesor, reformojë administratën publike dhe sigurojë një proces transparent, të bazuar në meritë dhe jo-politik të përzgjedhjes. Veç kësaj, qeveria nuk ishte e përkushtuar në nisjen e reformave strukturale për ta zhvilluar sistemin e arsimit dhe promovuar lidhjen më të mirë ndërmjet kësaj të fundit dhe tregut të punës.

Lëvizja përpara

ERA duhet të mbetet dokumenti thelbësor që shtyn përpara rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian. Prandaj, siç është paraparë në dokumentin e ERA-së, duhet të thirret një takim për ta diskutuar progresin dhe sfidat me të cilat përballet Kosova në procesin e zbatimit dhe të vlerësohet rruga për të lëvizur përpara. Kjo duhet ta përfshijë Kryeministrin Haradinaj dhe Komisionarin Han.

Për arritjen e rezultateve më të mira, qeveria duhet ta rritë përkushtimin e saj drejt realizimit të reformave të domosdoshme dhe vendimtare. Duke pasur parasysh se institucionet kanë arritur t'i përmbushin vetëm 39 për qind të objektivave të deklaruara në ERA, qeveria duhet të dalë me iniciativa më inovative për ta përshpejtuar këtë proces dhe arritur rezultate konkrete. Zgjedhja për të vazhduar me strategjinë e 'Strucit' vetëm se do ta dëmtojë të ardhmen e Kosovës; është e rëndësishme madhore që t'i përkushtohet në tërësi zbatimit të të gjitha prioriteteve dhe objektivave të theksuara në Planin e Veprimit të ERA-së.

Transparenca në vendimet qeveritare është thelbësore në këtë proces. Në këtë pikë, reformat që bien nën ERA duhet të merren në bashkërendim me të gjithë hisedarët relevant. Qeveria duhet të angazhohet në mënyrë konstruktive me opozitën, shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit për të krijuar një konsensus të gjerë, meqë zbatimi i ERA-së kërkon mbështetjen dhe bashkëpunimin e të gjitha palëve dhe institucioneve nga i tërë spektri politik. Është tejet e rëndësishme që të fuqizohet dhe promovohet bashkëpunimi i mirë ndërmjet institucioneve qeveritare për ta arritur rezultate më të mira gjatë procesit të zbatimit. Në këtë pikë, për të pasur një proces të suksesshëm, të ndërmerren të gjitha reformat e nevojshme dhe zhvillohet një bashkëpunim i frytshëm ndërmjet hisedarëve të lartëcekur, institucionet e Kosovës duhet të vazhdojnë të pranojnë mbështetje politike dhe financiare nga BE-ja.

ANEKSI 1: MATRICA E MONITORIMIT TË ERA - SË

NR	PRIORITET	VEPRIMET DHE TREGUESIT	AFATI	INSTITUC. PËRGJEGJ.	K1 – K2 2017	K3 – K4 2017			
					VLERËSIMI				
I. QEVERISJA E MIRË DHE SUNDIMI I LIGJIT									
1.1	Rishikimi dhe miratimi i legjislacionit që e bënë të detyrueshëm pezullimin dhe/ose e zyrtarëve publik të akuzuar dhe denuar për korrupsion.	<p>1.Koncept dokumenti mbi ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publikë të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.</p> <p>2.Miratimi i legjislacionit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion.</p>	K4 2016	MD Kryetari Kuvendi	1) Pjesërisht e plotësuar				
					2) E paplotësuar	2) Pjesërisht e plotësuar			
<p>Gjendja për periudhën K1 – K2.</p> <p>1. Ministria e Drejtësisë ka organizuar disa takime lidhur me hartimin e koncept dokumentit për ndryshimin e legjislacionit në fuqi për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion. Në këtë koncept dokument janë prezantuar pikëpamjet e anëtarëve të grupit dhe të ekspertëve të huaj. Poashtu, gjatë këtyre takimeve janë prezantuar edhe pikëpamjet e përfaqësuesve nga shoqëria civile dhe nga ata të Zyrës së BE-së në Kosovë. Grupi punues në kuadër të MD-së në bashkëveprim me anëtarët e grupit punues ka hartuar draftin e koncept dokumentit, ky draft do të dërgohet për konsultime me publikun. Në këtë draft janë marrë parasysh gjithashtu edhe propozimet dhe sygjerimet e parashtruara nga akterët e involvuar përfshirë këtu ekspertët, Zyrën e Bashkimit Evropian dhe përfaqësues nga shoqëria civile.</p> <p>2. Miratimi i legjislacionit për të siguruar pezullimin dhe/ose largimin e detyrueshëm të zyrtarëve publik të akuzuar dhe dënuar për korrupsion, është paraparë të miratohet në K4 2017.</p>									

Gjendja për periudhën K3 – K4.

1. Grupi punues i Kodit Penal ka inkorporuar dispozita të reja që ndërlidhen me çështjen e pezullimit dhe largimit të zyrtarëve publikë, këto dispozita do të përfshihen në Kodin e Procedurës Penale. Me date 14 Shkurt 2018 është dërguar për konsultime paraprake drafti final i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe me date 5 Mars 2018 pritet të përfundojnë këto konsultime, pastaj, do të adresohen komentet dhe do të lansohen në platformen online për konsultime me pubikun.

2. Projektligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike, është në procedurë të shqyrtimit në Kuvend. Me datë 12.12.2017 është shqyrtuar në parim nga Komisioni Funkcional i Kuvendit.

1.2	Ndryshimi i ligjit për konfliktin e interesit dhe rregulloret e ndërlidhura, duke i harmonizuar me standardet evropiane dhe duke paraqitur kushtet e sakta në të cilat zyrtarët publik mund të kenë punësim apo emërim shtesë	<p>1. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike duhet të ndryshohet, në harmoni me rekomandimet e BE-së:</p> <p>a) duhet të përcaktohen qartë kategoritë e zyrtarëve publik;</p> <p>b) duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarëve iu lejohet dhe iu ndalohet t'i kryejnë përderisa mbajnë postin;</p> <p>c) duhet të theksohen qartë aktivitete që zyrtarët e kanë të ndaluar t'i ushtrjnë pas përfundimit të mandatit;</p> <p>d) duhet të theksohen qartë obligimet e zyrtarëve dhe eprorëve të tyre në situata të konfliktit të interesit;</p> <p>e) duhet të theksohen qartë procedurat që duhet aplikohen pas paraqitjes së konfliktit të interesit.</p>	K4 2016	MD Kuvendi	<p>I) Pjesërisht e plotësuar</p> <p>a) E plotësuar</p> <p>b) E plotësuar</p> <p>c) E plotësuar</p> <p>d) E plotësuar</p> <p>e) E plotësuar</p>
-----	---	--	---------	---------------	--

Gjendja për periudhën K1 – K2.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit është tërhequr nga procedura, dy herë, gjatë kohës kur ka qenë si plotësim-ndryshimi i ligjit aktual, ndërsa në fazën e tretë është hartuar si Projektligj i Ri në bashkëpunim me përfaqësuesit e Agjencisë kundër Korrupsionit, ekspert nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e BE-së.

Projektligji parashikon masa konkrete për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit që duhet të merret nga zyrtari publik kur ndodh konflikti i rastit të interesit.

Me 12.04.2017 është mbajtur dëgjimi publik për Projektligjin nr.05/ L-140 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për komentimin dhe vërejtjet nga institucionet dhe shoqëria civile. Me 18.04.2017 ka qenë afati i fundit i pranimit të ndryshimeve me shkrim nga akterët kryesor.

a. Kategoritë e zyrtarëve publikë të Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, megjithëse nuk janë të cekura në mënyrë eksplicite, përcaktohen sipas përkufizimit të parashikuar në Kodin Penal dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurive. Ky projektligj është harmonizuar me ligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e

pasurisë së zyrtarëve të lartë.

b. Projektligji specifikon në mënyrë të veçantë aktivitetet e zyrtarëve publikë që lejohen dhe nuk lejohen të bëjnë gjatë kohës që janë në detyrë

c. Projektligji qartë liston aktivitetet që zyrtarët publikë janë të ndaluar të kryejnë pas largimit nga zyra duke përcaktuar qartë kohëzgjatjen e kësaj ndalese.

d. Projektligji thekson qartë detyrimet e zyrtarëve publikë dhe eprorëve të tyre për parandalimin dhe zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit.

Gjendja për periudhën K3 – K4.

Projektligji është aktualisht në fazën e shqyrtimit dhe amendamentimit në komisionin funksional.

1.3	Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies në financimin e partive politike: a. Realizimi i auditimeve të pavarura të financave të partive për vitet 2013-2015 b. Sigurimi i publikimit të raporteve financiare të partive politike, siç parashihet me ligj	1. Publikohen raportet financiare të partive politike dhe të ndërmerren veprim efikas për zbatim kundër atyre që nuk e përmbushin këtë;	1-3: K4 2016	ZKM, KQZ, Kuvendi (Kryesia, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Sekretariati)	1) Pjesërisht e plotësuar	1) E plotësuar
		2. Të ofrohet financim adekuat për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të partive politike;			2) E plotësuar	
		3. Përzgjidhen auditorët e pavarur nëpërmjet thirrjes së hapur;			3) E paplotësuar	3) E plotësuar
		4. Ndryshohet ligji për financimin e partive politike për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe zbatim dhe sanksione efikase, në bazë të konsultimeve të gjera publike.	4: K4 2017		4) Në zhvillim e sipër	4) Pjesërisht e plotësuar

Gjendja për periudhën K1 – K2

1. Disa nga raportet financiare janë publikuar nga disa subjekte politike por asnjëra nga raportet financiare nuk janë të audituara. Pritet që pasi të fillojë punën Legjislatura e VI të bëhet tërheqja e shortit për fillimin e punës. Kontrata është e nënshkruar me operatorin e ekonomik dhe pasi pasi të jetë bërë tërheqja e shortit do të filloj procesi i auditimit.

2. Për vitin 2017, buxheti shtesë për financimin adekuat për prokurimin e shërbimeve të auditimit për raportet financiare të partive politike është ndarë. Për auditimin e raportit vjetor financiar dhe raportit të deklarimit financiar të fushatës të subjekteve politike – 2013, 2014, 2015, 2016, me numër të prokurimit KU101 17 007 221 (101-17-1736-2-2-1), u bë përzgjedhja e operatorit ekonomik në listën e operatorëve ekonomikë të interesuar, ku ishin 10 operatorë ekonomikë. Ofertat i dorëzuan dy operatorë ekonomikë: 1. Audit & Conto dhe 2. Audit Group. Fitues u përzgjedh operatori ekonomik i përgjegjshëm: Audit & Conto me çmimin e ofertës prej 118,320.00 euro. Njoftimi për dhënje u publikua në faqen elektronike (e-prokurimi) më 01.06.2017.

3. Sipas Ligjit aktual për financim e subjekteve politike, çështja e përzgjedhjes së auditorëve të jashtëm është e rregulluar. Mirëpo, me datë 17.10.2017 do të bëhet caktimi i shortit për auditimin e financave të partive politike. Komisioni për Mbikqyrjen e Financave Publike pritët të takohet që të diskutojnë për vazhdimin e procedurave për auditimin e raporteve financiare të partive politike.

4. Zyra e Kryeministrit ka themeluar ekipin përgjegjës për hartimin e Koncept dokumentit për politikën “Financimi i subjekteve politike”. Në përbërjen e ekipit përgjegjës janë përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm Ministria e Financave, Ministria e Integritimit Evropian etj. Në këtë aspekt Zyra e Kryeministrit ka ftuar përfaqësues nga Shoqëria Civile të cilët kanë ofruar mendimet dhe propozimet e tyre se si ky proces mund të adresohet. E planifikuar të realizohet gjatë K4 2017.

INFORMATA:

Raportet financiare: Gusht 2017

SUBJEKTI POLITIK	WEB	PUBLIKIMI RAPORTEVE FINANCIARE (2013-2015)				AUDITIMI
PDK	Funksionale.	Nuk janë të publikuara në web faqe të PDK-së.				Të pa audituara
LDK	Funksionale.	Viti	Përfaqësuesi financiar	Të hyrat	Shpenzimet	Të pa audituara
		2013	Lutfi Zharku	1290096.56 euro	953179.84 euro	
		2014	Lutfi Zharku	1041653.40 euro	955013.81 euro	
		2015	Lutfi Zharku	976683.81 euro	457437.21 euro	
		2016	Lutfi Zharku	973501.22 euro	499526.72 euro	
AAK	Funksionale.	Viti	Përfaqësuesi financiar	Të hyrat	Shpenzimet	Të pa audituara
		2013	Valon Tolaj	567464.60 euro	826015.62 euro	
		2014	Valon Tolaj	504173.61 euro	667481.82 euro	
		2015	Valon Tolaj	370230.38 euro	391811.14 euro	
		2016	Valon Tolaj	421476.53 euro	448583.43 euro	
AKR	Funksionale.	Nuk janë të publikuara në web faqe të AKR-së.				Të pa audituara
VV	Funksionale. Me 4 Gusht 2017 VV ka publikuar edhe pasqyrat financiare për zgjedhjet e parakoshme të 11 Qershorit 2017.	Viti	Përfaqësuesi financiar	Të hyrat	Shpenzimet	Të pa audituara
		2013	Ilir Cacaj	726258.84 euro	816428.05 euro	
		2014	Ilir Cacaj	640448.79 euro	588944.15 euro	
		2015	Ilir Cacaj	602729.98 euro	589138.42 euro	
		2016	Ilir Cacaj	-	-	
NISMA	WEB funksional por pasqyrat financiare janë të publikuara në faqen që Nisma ka në Facebook, dhe të shpërndara pastaj në WEB për 2015.	Viti	Përfaqësuesi financiar	Të hyrat	Shpenzimet	Të pa audituara
		2013	Faton Thaçi	-	-	
		2014	Faton Thaçi	158011.66 euro	177962.56 euro	
		2015	Faton Thaçi	194432.05 euro	218807.43 euro	
		2016	Faton Thaçi	206972.31 euro	236815.86 euro	

Gjendja për periudhën K3 – K4

1. Raportet financiare të audituara: Shkurt 2018

Subjekti politik	Raportet financiare (2012-2016)					
PDK	Viti	2016	2015	2014	2013	2012
	Hyrjet	1214329.18	1206517.02	1148431.12	1052852.25	1196176.76
	Shpenzimet	1182090.49	848569.64	1341830.68	1721168.53	891739.08
	Suficiti	32238.69	357947.38	(193399.56)	(668316.28)	304437.68
LDK	Viti	2016	2015	2014	2013	2012
	Hyrjet	986865.54	980836.14	970307.14	855216.84	896799.00
	Shpenzimet	515415.68	459789.54	1036139.66	1293021.07	450594.52
	Suficiti	471449.86	521046.60	(65832.52)	(437804.23)	446204.48
AAK	Viti	2016	2015	2014	2013	2012
	Hyrjet	341010	506094.02	517202.14	397899	397663
	Shpenzimet	382590.76	476773.53	631813.31	389409.62	449770
	Suficiti	(41580.76)	29320.49	(114611.17)	8489.39	(52106.90)
AKR	Nuk janë të publikuara.					
VV	Viti	2016	2015	2014	2013	2012
	Hyrjet	580805	597968	696900	754415	621349
	Shpenzimet	576440	584378	645794	844230	565667
	Suficiti	4365	13591	51104	(89815)	55682
NISMA	Viti	2016	2015	2014	2013	2012
	Hyrjet	206972.31	194432.05	158011.65	-	-
	Shpenzimet	236815.86	218807.43	177962.56	-	-
	Suficiti	(29843.55)	(24375.38)	(19950.91)		

2/3. Në mbledhjen e e 19 Tetorit 2017, të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të kryesuar nga kryetari Driton Selmanaj, është bërë tërheqja e shortit lidhur me Auditimin e Raporteve Vjetore Financiare dhe Raportet e deklarimit financiar të fushatës, së subjekteve politike, për vitet 2013, 2014, 2015, dhe 2016.

Procesi i tërheqjes së këtij shorti është zhvilluar me zarfa të mbyllur, ku emrat e auditorëve dhe të subjekteve politike janë tërhequr nga zyrtarë të Kuvendit, për 10 auditorë që do të auditojnë nga 7 subjekte politike. Auditorët që do të përfundojnë këtë proces janë: Ymer Shatri, Muhamet Feka, Agron Mustafa, Elmije Osmani Shatri, Qerim Qerimi, Haxhi Nimanaj, Besa Sahitaj Berishaj, Fatmir Mehmeti, Njazi Jakupi dhe Fadil Hyseni. Kryetari i Komisionit, Driton Selmanaj, sqaroi se auditimi do të fillojë menjëherë pas caktimit me short të auditorit për subjektin politik përkatës dhe duhet të përfundojë në afat prej 45 ditësh, për të përfunduar raportin.

4. Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 29 Janarit 2018 ka marrë vendim për krijimin e komisionit për hartimin e Projektligjit për financimin e partive politike.

1.4	Realizimi i rishikimit të pavarur të mekanizmave të llogaridhënies së të gjitha institucioneve të pavarura, agjencive dhe organeve rregullatore, përcjelljen e rekomandimeve të tyre dhe miratimin e masave legjislative që përcaktojnë qartë rolet, përgjegjësitë dhe linjat e llogaridhënies së këtyre institucioneve	1. Kryhet një analizë cilësore e agjencive të pavarura dhe agjencive të pavarura rregullatore (analiza mbi rregulloren e marrëdhënies së punës, pagave, themelimin dhe organizimin e agjencive);	1: K4 2016	MAP Kuvendi MF ZKM	1. E plotësuar	
		2. Zotohet mbi zbatimin e rekomandimeve që dalin nga analiza cilësore;	2: K4 2016		2. E plotësuar	
		3. Zhvillohet një koncept dokument për projektligjin mbi organizimin e administratës publike, shërbimin civil dhe pagat	3-4: K4 2017		3. E plotësuar E plotësuar para kohës së paraparë.	
		4. Miratohet pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.			4. Në zhvillim e sipër	4. E paplotësuar

Gjendja për periudhën K1 – K2

1.Analiza është kryer në Nëntor të 2016.

2.MAP me mbështetjen e SIGMA-së ka përgatitur një rishikim të analizës së cilësisë së institucioneve / agjencive të pavarura dhe organeve të pavarura rregullatore dhe ka ofruar informata për sfidat dhe boshllëqet ligjore brenda këtyre institucioneve, duke analizuar plotësisht elementet e themelimit, organizimit, pagave dhe kontratave të punësimit. Gjetjet e kësaj analize të cilësisë përbëjnë numrin e madh të institucioneve të pavarura dhe mungesën e llogaridhënies. Raporti ofron informacion rreth 33 institucioneve dhe agjencive të pavarura të Kuvendit, dhe 46 organeve qendrore dhe agjencive të Qeverisë. Përveç gjetjeve, analiza gjithashtu ofron rekomandime konkrete për vendosjen e linjave të llogaridhënies dhe racionalizimin e mëtejshëm, si dhe udhërrëfyesin për zbatimin e tyre. Analiza e cilësisë ka identifikuar se nuk ka linja të qarta të llogaridhënies as në Asamble as në Institucionet / Agjencitë Qeveritare.

3.Bazuar në gjetjet e këtyre analizave, me 29.03.2017: MAP-i me ndihmen e SIGMA-së, ka hartuar dokumentet e nevojshme për hartimin e pakos së legjislacionit për reformë të Administratës Publike, siç janë: 1) Ligji për organizimin e Administratës Publike; 2) Koncept dokumenti për Ligjin për pagat në sektorin publik dhe 3) Koncept dokumenti për shërbimin civil në RKS.

Koncept Dokumentet, janë miratuar me 15 maj 2017 nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe në harmoni me prioritetet e dakorduara në Agjendën e Reformave Evropiane. Me vendim nr. 103/2017 datë 10.07.2017 është formuar grupi punues për hartimin e tri ligjeve bazike të Reformës së Administratës Publike, ku janë mbajtur takimet e para të Grupit Punues. Sa i përket sygjërimeve nga shoqëria civile, janë pranuar sygjërime nga HANDIKOS dhe GAP të cilat janë përfshirë në Koncept Dokumente, të miratuara me 15 maj 2017 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

4.Ligji për Organizimin e Administratës Publike nuk është hartuar ende.

Bazuar në draftin e koncept dokumentit, Qeveria është në fazën e krijimit të një kornize ligjore (Ligji mbi Administratën Shtetërore që do të ndryshohet dhe riemërohet si Ligji për Organizimin e Administratës Publike), i cili synon të përcaktojë elementet e organizimit dhe funksionimit të administratës publike përtej Administratës shtetërore, duke përfshirë institucionet dhe agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi. Projektligji parashihet të miratohet nga Qeveria në K4 2017. Kuadëri legjislativ (ndryshe nga Ligji për Administratën Shtetërore) synon të parashikojë qartë parimet bazë dhe minimumin e rregulla lidhur me themelimin, organizimin e te brendshëm, llogaridhënien, qeverisjen, bashkëpunimin, delegimin, mbikëqyrjen dhe organizimin rajonal të organeve të administratës publike dhe përcaktimin e tipologjive të administratës publike.

Pas miratimit të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji i cili ka qenë edhe parakusht për miratimin e projektit IPA 2014, projekti ka filluar të mbështes zbatueshmërinë e këtij ligji. Janë caktuar ekspërtet për harmonizimin e procedurave të veçanta që gjenden në ligjet e tjera sektoriale me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative, ku janë identifikuar më shumë se 400 ligje sektoriale të cilët parashohin procedura të veçanta.

Gjendja për periudhën K3 – K4

4. Pakoja legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike:

Bazuar në vendimin nr. 103/2017, të datës 10 korrik 2017, Qeveria ka miratuar themelimin e grupeve të punës të mandatuara për hartimin e dy ligjeve të lartpërmendura, si dhe Ligjin për Pagat, pasi ky i fundit është kthyer në Qeveri për shqyrtim të mëtejshëm. Është parashikuar që këto tre ligje të unifikohen dhe miratohen si një pako e vetme ligjore deri në fund të vitit 2017. Mirëpo, aktualisht, Grupi Punues ka hartuar dhe është në fazën e finalizimit të Projektligjit për Shërbimin Civil dhe Projeligjin për Administratën Publike.

Pako legjislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike parashihet të realizohet në fund të Qershorit 2018.

1.5	Sigurimi se pakoja e planifikuar legislative, që mbulon shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës shtetërore, përgatitet në mënyrë të koordinuar në një proces gjithëpërfshirës dhe të bazuar në dëshmi në bazë të koncept dokumenteve të dakorduara në nivel qeveritar	<p>1. Hartohen koncept dokumente për projektligjet mbi: shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike; dhe</p> <p>2. Të miratohet pakoja legislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike.</p>	<p>1: K4 2016</p> <p>2: K4 2017</p>	MAP Kuvendi MF ZKM	<p>1) E plotësuar</p> <p>2) Në zhvillim e sipër</p> <p>2) E paplotësuar</p>	
<p>Gjendja për periudhën K1 – K2</p> <p>1. Janë hartuar dhe janë miratuar koncept dokumente për projektligjet mbi: shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike; 2. Pako legislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike, nuk është miratuar ende.</p>						
<p>Gjendja për periudhën K3 – K4</p> <p>2. Pako legislative mbi shërbimin civil, pagat dhe organizimin e administratës publike parashihet të realizohet në fund të Qershorit 2018.</p> <p>Aktualisht, bazuar në vendimin nr. 103/2017, të datës 10 korrik 2017, Qeveria ka miratuar themelimin e grupeve të punës të mandatuara për hartimin e dy ligjeve të lartpërmendura, si dhe Ligjin për Pagat, pasi ky i fundit është kthyer në Qeveri për shqyrtim të mëtejshëm. Është parashikuar që këto tre ligje të unifikohen dhe miratohen si një pako e vetme ligjore deri në fund të vitit 2017. Mirëpo, aktualisht, Grupi Punues ka hartuar dhe është në fazën e finalizimit të Projektligjit për Shërbimin Civil dhe Projeligjin për Administratën Publike.</p>						
1.6	<p>Sigurimi i një procesi të përzgjedhjes që është transparent, i bazuar në merita dhe jo-politik, në harmoni me ligjin, për të gjitha institucionet e pavarura, agjencitë dhe organet rregullative, si dhe në kompani publike;</p> <p>Zbatimi i plotë i rekomandimeve nga Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit</p>	<p>a. Ndryshimi i legjislacionit në fuqi për përzgjedhjen e institucioneve të pavarura për të siguruar procedura të fuqishme, transparente dhe të bazuara në merita të përzgjedhjes së kandidatëve:</p> <p>a1) Publikimi i CV-ve të kandidatëve në listë të ngushtë;</p> <p>a2) Përfshirja e shoqërisë civile në komisionet</p>	a.2016-2017	ZKM Kuvendi	a1) Në zhvillim e sipër	a1) Pjesërisht e plotësuar

	(AKK-DLK-3113/15)	<p>përzgjedhëse, në bazë të një përzgjedhje transparente dhe të hapur të përfaqësuesve të shoqërisë civile;</p> <p>a3) Fuqizimi dhe qartësimi i kriterëve minimale për kandidatët përmes përfshirjes së kriterëve të ngjashme me nenin 17 paragrafi 2 i ligjit mbi NP-të, për shembull, në ndryshimet në ligjin mbi konfliktin e interesit, duke i bërë kështu të aplikueshme në të gjitha agjencitë e pavarura dhe organet rregullative.</p> <p>b. Qeveria zotohet të veprojë sipas rekomandimeve të lëshuara nga AKK më datë 15.02.2016 (AKK-DLK-3113/15) në lidhje me emërimet në 9 borde të NP-ve:</p> <p>b1) Formulari/deklarata nën betim ndryshohet për të pasqyruar ligjin, për të gjitha emërimet e ardhshme</p> <p>b2) ZKM-ja ndërmerr veprim sipas nenit 17.5 të ligjit (d.m.th 17.5 Çdo person i cili mban ose aplikon për një pozitë të drejtorit duhet të japë një deklaratë nën betim në të cilën deklaron se ai/ajo i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafëve 1-3 të këtij neni. Çdo përgënjeshttrim material – qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca – ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm dhe, nëse është e aplikueshme, largimin e personit.)</p> <p>b3) ZKM-ja ndërmerr veprime kundër zyrtarëve që kanë hartuar këtë formë/deklaratë që nuk është në përputhje me ligjin.</p> <p>b4) Sigurohet zbatimin e MM të nënshkruar ndërmjet</p>	b. K4 2016		a2) Në zhvillim e sipër	a2) E paplotësuar
					a3) Në zhvillim e sipër	a3) E paplotësuar
					b1) E plotësuar	
					b2) E plotësuar	
					b3) E plotësuar	

		Kuvendit, Qeverisë në njërën anë dhe Ambasadës së MB në Prishtinë në anën tjetër, për emërimet e anëtarëve të bordit të institucioneve të pavarura dhe agjencive.			b4) E plotësuar
--	--	---	--	--	-----------------

Gjendja për periudhën K1 – K2

a1) Publikimi i Cv- të kandidatëve për dy bordet për dy Ndërmarrje Publike për të cilat janë duke u zhvilluar procedurat e Prokurimit është në procedurë.

a2) Sa i përket përfshirjes së Shoqërisë Civile në komisionet rekomanduese, në Komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve për Bordin e PTK, CIVIKOS tashmë ka emëruar përfaqësuesin e saj si vëzhgues meqenëse në komisionin për përzgjedhjen e kandidatëve për Bordin e KEK ka qenë kohë shumë e shkurtër për të dërguar një përfaqësues. Zyra e Kryeministrit ndër përgjegjësit e saj ka edhe përfshirjen e shoqërisë civile në cilësinë e vëzhguesit në procesin e emërimit të drejtorëve në Ndërmarrjet Publike. Fillimisht është menduar që të shkohet me plotësim/ndryshimin e Ligjit për NP, me s'çrast ZKM i është drejtuar Ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të MZHE-së, ku kanë rekomanduar fillimin e procedurave për plotësim/ndryshimin e Ligjit për NP, për të mundësuar përfshirjen e shoqërisë civile në këto komisione rekrutuese. Mirëpo, tani pas dakordimit me Zyrën e BE, për përfshirjen e shoqërisë civile në këto komisione në cilësi e vëzhguesit, si dhe bazuar në opinionin e Zyrës Ligjore të ZKM-së, (përfshija e përfaqësuesve të Pavarur nga Shoqëria Civile në rolin e vëzhguesit në këtë proces do të rris transparencën e punës së Qeverisë, ndërsa vendimmarrja do të bëhet siç parashihet në legjislacionin në fuqi).

Prandaj, shoqëria civile është e në të gjitha komisionet rekrutuese për emërimin e drejtorëve në NP, në cilësinë e vëzhguesit.

a3) Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2), të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 75, paragrafi 3 të Rregullores nr.09/2011 për Punën e Qeverisë së Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.15, dt.12.09.2011), nenin 16 (6 dhe 7) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe nenin 15 (paragrafi 2 dhe 3) të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta Zyrtare nr.31, 15.06.2008) Sekretari i Përgjithshëm ka nxjerr: **RREGULLAT MBI IDENTIFIKIMIN E KANDIDATËVE PËR DREJTORË TË BORDEVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE DHE METODOLOGJINË E VLERËSIMIT.**

b1) b2) Është plotësuar/ndryshuar deklarata nën betim, bazuar në legjislacionin në fuqi. (Sipas Nenit 17 të Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike). Janë zbatuar Rregullat mbi Identifikimin e Kandidatëve për Drejtorë të Bordeve të Ndërmarrjeve Publike dhe Metodologjinë e Vlerësimit.

b4) Në lidhje me rrjedhën e procesit të zbatimit të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar mes Kuvendit të Kosovës, Qeverisë Kosovës dhe Ambasadës së Britanisë në Kosovë me qëllim të bashkimit të përpjekjeve për zgjedhjen pozitive drejtuese të ndërmarrjeve dhe institucioneve publike, me datën 01.02.2017 është shpallur konkursi për Bordin e Ndërmarrjes Publike Qendrore të KEK-ut dhe është mbyllur me datën 06 mars 2017, gjithsej kanë aplikuar 75 kandidatë.

Gjendja për periudhën K3 – K4

a.1. Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 10 Nëntorit 2017 ka emëruar bordin e ri të KEK-ut, por ata nuk i kanë treguar edhe emrat e anëtarëve të këtij bordi. Vendimi sekret i qeverisë vjen vetëm 4 ditë pasi Qeveria e Kosovës e hapi dhe e anuloi një konkurs të ri për zgjedhjen e bordit të KEK-ut. Në konkursin e hapur janë përshkruar të gjitha kërkesat profesionale që duhet t'i plotësojë një person për t'u bërë drejtor në Bordin e KEK-ut. Konkursi parashihej të mbetej i hapur deri më datën 7 dhjetor, mirëpo kjo periudhë nuk është respektuar dhe si rezultat i kësaj nënkupton se ky vendim ka qenë i politizuar.

Përveq që, nuk është publikuar lista e ngusht e CV-ve të kandidatëve, emrat e tyre janë kuptuar vetëm pas një jave. Emrat e anëtarëve të bordit të ri të KEK-ut i janë dërguar një gazete vendore nga Zyra për Media e Zyrës së Kryeministrit dhe emrat e tyre janë: Faruk Hajrizi, Gjelosh Vataj, Mehdi Pllashniku, Izet Ibrahim, Filanza Beqiri-Hoxha dhe Ilir Rama..

Lajmërimi i lartëcekur për Bordin e ri të KEK-ut:

“Ju njoftojmë se është anuluar konkursi për drejtor të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore – Korporata Energjetike e Kosovës – KEK-u i publikuar sot me datën 07 nëntor 2017 deri me datën 07 dhjetor 2017”, ishte shkruar në njoftimin e publikuar në ueb-faqen e ZKM-së.

“Afati i konkursit është i hapur 30 ditë nga data e publikimit në shtypin ditor (nga data 07 nëntor 2017 deri me datën 07 dhjetor 2017)”, thuhet në njoftimin e Zyrës së Kryeministrit.”

Pra, përveq që nuk është respektuar koha e konkursit të hapur me të njëjtin veprim nuk është respektuar Memorandumi i Qeverisë me Ambasaden e Britanike.

Për sa i përket Bordit të PTK-së ka 15 Muaj që ajo vepron pa bord, konkretisht që nga Dhjetori i viti 2016. Pritet që, për PTK-në dhe Trepçën me 25 Mars të realizohen intervistat finale dhe deri në fund të Marsit 2018 pritët që bordet e këtyre 2 ndërmarrjeve të funksionalizohen.

Gabimin tjetër që e ka bërë Qeveria është kërkesa ndaj kompanisë britanike të mos përfshihet në emërimin e Bordit Mbikëqyrës të Trepçës.

a.2) Përderisa vendimi i Qeverisë ka qenë sekret kjo nënkupton se janë ndërmarrë veprime pa prezencën e shoqërisë civile.

a.3) Kriteret janë të paraqitura në aplikimet për këto pozita por se sa mirren parasysh tregojnë veprimet e lartëcekura.

1.7	Zbatimi i vendimit të qeverisë të muajit mars 2016 mbi futjen e prokurimit të detyrueshëm, së bashku me afatet kohore të përmendura aty	1. Fillohet faza e dytë të pilot projektit të e-prokurimit	Korrik - Shtator 2016	MF KRPP	1) E plotësuar
		2. Zbatohen ndryshimet e ligjit të prokurimit në platformën elektronike	Korrik - Dhjetor 2016		2) E plotësuar
		3. Trajtohen zyrtarët publik në nivel lokal	Korrik - Dhjetor 2016		3) E plotësuar

	4. Çertifikohen zyrtarët publik në nivel qendror.	Shtator 2016	4) E plotësuar
	5. Çertifikohen zyrtarët publik në nivel lokal	Dhjetor 2016	5) E plotësuar
	6. Testohen modulet elektronike të prokurimit	Shtator 2016	6) E plotësuar
	7. Hartohen udhëzimet operative mbi e-prokurimin. Qeveria duhet t'i ofrojë publikut të dhëna standarde të lexueshme nga makina në kohë reale të kontratave të prokurimit.	Shtator - Dhjetor 2016	7) E plotësuar

Gjendja për periudhën K1 – K2

1.Vendimi i Qeverisë, i marsit 2016, për prokurimin elektronik është duke u zbatuar plotësisht. Është përfunduar platforma elektronike dhe të gjitha autoritetet kontraktuese e kanë të obligueshme t'i vendosin aktivitetet e prokurimit në platformën elektronike dhe aktivitetet e tyre të prokurimit janë duke i zhvilluar nëpërmjet kësaj platforme. OE regjistrohen në sistem të pavarur.

2.Është zhvilluar legjislacioni i nevojshëm për zbatimin e ndryshimeve të Ligjit të Prokurimit përfshirë modulet dhe formularët e rinj. Gjatë vitit të kaluar është lansuar pilotimi i e-prokurimit në institucionet qendrore, ndërsa nga 1 janari i këtij viti edhe në institucionet e nivelit lokal.

3.Janë mbajtur trajnimet për prokurimin elektronik me grupin e parë të zyrtarëve të nivelit lokal dhe është bërë çertifikimi i tyre pas përfundimit të provimeve.

4.Janë mbajtur trajnimet për prokurim publik për nivelin qendror me grupin e parë të zyrtarëve të nivelit qendror dhe është bërë çertifikimi i tyre pas përfundimit të provimeve.

5.Janë mbajtur trajnimet me grupin e parë të zyrtarëve të ndërmarrjeve publike, si dhe është bërë çertifikimi i tyre pas përfundimit të provimeve.

6.Procesi për testimin e moduleve elektronike ka përfunduar.

7.KRPP për të gjithë përdoruesit ka nxjerrë udhëzues dhe manuale të cilët janë në dispozicion në web-faqen e KRPP-së, si dhe në platformën e prokurimit elektronik (Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik, Regjistrimi i Autoritetit Kontraktues, Përgatitja dhe publikimi i tenderit, Regjistrimi i Operatorit Ekonomik, Manuali për OE - Përgatitja dhe dorëzimi i Ofertës.).

1.8	Fuqizimi i kapaciteteve të Departamentit Ekonomik dhe Divizionit Fiskal në Departamentin Administrativ të Gjykatës së Shkallës së Parë në Prishtinë, përfshirë në fushat e tatimit dhe doganave, me qëllim të reduktimit të rasteve të grumbulluara	KGJK do të realizojë një vlerësim të nevojave për rritjen e numrit të gjyqtarëve në Gjykatat Themelore Ekonomike. Vlerësimi do të përcaktojë kostot e buxhetit, si dhe kapacitetet njerëzore të nevojshme për reduktimin e rasteve të grumbulluara në Gjykatat Themelore Ekonomike.	K1 2017	KGJK	E paplotësuar	Pjesërisht e plotësuar
<p>Gjendja për periudhën K1 – K2</p> <p>Në bazë të rekomandimit të KGJK-së janë dekretuara 52 gjyqtar të Gjykatave Themelore në Republikën e Kosovës, ku nga ata 22 janë përcaktuar që të punojnë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Nuk është bërë ndonjë vlerësim të nevojave, kryetari i kësaj gjykate nëse e sheh te nevojshëm që ky departament duhet të forcohet atëherë ka mundësi me kompetencë që nga këta 22 gjyqtar të caktoj ndonjërin prej tyre në këtë departament.</p> <p>Departamenti administrativ përkatësisht divizioni fiskal, në bazë të koncept dokumentit për konfliktin administrativ që është sponsorizuar nga MAP është paraparë që të shtohet numri edhe për 7 gjyqtar, 7 bashkëpunëtor profesional dhe 7 zyrtar ligjor vetëm për këtë departament.</p>						
<p>Gjendja për periudhën K3 – K4</p> <p>Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka përgaditur një analizë më të cilën pritet të identifikohen nevojat në Departamentin Ekonomik dhe Divizionin Fiskal në Gjykatat Themelore.</p>						
1.9	Vazhdimi i fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë nëpërmjet fuqizimit të kapacitetit të Prokurorisë Speciale që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë.	<p>1. Plotesim - ndryshimi i Ligjit mbi Prokurorin e Shtetit për të mundësuar rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, për hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit dhe krimit të nivelit të lartë.</p> <p>2. Ofrimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Prokurorisë Speciale për të kryer hetime financiare dhe për të konfiskuar pasuri.</p>	K2 2017	MD IGJK	<p>I.Pjesërisht e plotësuar</p> <p>Në fazën fillestare</p>	<p>I.Pjesërisht e plotësuar</p> <p>Në realizim e sipër</p>
<p>2. E plotësuar</p>						

Gjendja për periudhën K1 – K2

1. Ministria e Drejtësisë është duke e përgatitur Plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prokurorin e Shtetit, aktualisht gjenden në fazën e konsultimeve brenda Ministrisë.

2. Akademia e Drejtësisë për periudhën raportuese janar – shtator 2017, ka realizuar trajnimet në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar, hetimit financiar dhe konfiskimit si më poshtë:

1. Hetimi i krimeve financiare, me kohëzgjatje një (1) ditore. Përfitues të trajnimit ishin: 7 prokurorë, dy (2), nga Prokuroria e Apelit, pesë (5) nga Prokuroritë Themelore, një (1) gjyqtar, një (1) zyrtar nga Zyra Kombëtare e Auditimit dhe një (1) zyrtar nga Njësia për Inteligjencë Financiare.
2. Konfiskimi ndërkufitar i pasurive. Kohëzgjatje e trajnimit ka qenë dy (2) ditore. Në trajnim kanë marrë pjesë 22 pjesëmarrës, tre (3) prokurorë, një (1) prokuror nga PSRK, një (1) prokuror nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga niveli themelor. Pesë (5) gjyqtarë, 9 Zyrtarë nga Policia e Kosovës, dy (2) Zyrtarë nga Njësia për Inteligjencë Financiare, një (1) nga Agjencia Kundër Korrupsionit, dy (2) nga Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar.
3. Ngrirja e përkohshme e aseteve, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë. Kohëzgjatje e trajnimit ka qenë një (1) ditore. Përfitues të trajnimit ishin një (1) prokuror nga niveli themelor dhe 8 ishin gjyqtarë.
4. Hetimi financiar. Kohëzgjatje e trajnimit ka qenë dy (2) ditore. Në trajnim morën pjesë 15 pjesëmarrës nga të cilët 7 prokurorë, prej tyre ishin dy (2) prokurorë nga Prokuroria Speciale, një (1) prokurorë nga Prokuroria e Apelit dhe katër (4) prokurorë të nivelit themelor, dy (2) Zyrtarë nga Dogana e Kosovës, dy (2) nga Njësia për Inteligjencë Financiare, katër (4) Zyrtarë nga Policia e Kosovës.
5. Krimi i organizuar, trafikimi i drogës dhe rastet trans-nacionale, ngritja e aktakuzave”. Kohëzgjatja e trajnimit ka qenë dy (2) ditore. Përfitues të trajnimit ishin katër (4) prokurorë nga Prokuroria Speciale, tetë (8) Zyrtarë nga Policia e Kosovës, dy (2) bashkëpunëtor profesional nga PSRK, tre (3) zyrtarë ligjor nga PSRK.
6. Krimi i Organizuar. Kohëzgjatja e trajnimit ka qenë 1 ditore. Përfitues të trajnimit ishin 8 gjyqtarë dhe një (1) bashkëpunëtor profesional

Gjendja për periudhën K1 – K2

Projektligji për Prokurorin e Shtetit është miratuar në Qeveri. Projektligji ka kaluar për shqyrtimin e parë në Kuvend.

Projektligji është kritikuar se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, parimet dhe obligimet që Republika e Kosovës i ka marrë në raport me Bashkimin Evropian lidhur me zbatimin e prioritetëve që dalin nga Agjenda për Reformë Evropiane (ARE).

II. KONKURRUESHMERIA DHE KLIMA E INVESTIMEVE

2.1	<p>Promovimi i investimeve të huaja direkte:</p> <p>a) Fuqizimi në mënyrë të konsiderueshme i kapaciteteve dhe përmirësimi i organizimit të portfolios së brendshme të Agjencisë së Kosovës për Investime për t'i mundësuar përmirësimin e performancës për promovimin dhe mbështetjen e investimeve, sektorit privat dhe zhvillimit të NVM-ve;</p> <p>b) Krijimi i një program të shërbimit dhe kujdesit pasues për investitorët e mundshëm dhe mekanizmin e ankesës që ka kompetenca të mjaftueshme për ofrimin e shërbimeve të tilla</p>	a.1. Shqyrtim i thellë i fushëveprimit të përgjegjësive të KIESA, aktiviteteve të saj dhe përshkrimeve të punës;	a.1. K1 2017	MTI ZKM	a1) E plotësuar	
		a.2. Ristrukturimi i KIESA për t'i mundësuar që të përmbush me efikasitet përgjegjësitë e saj dhe të zbatojë prioritetet, ndarjen e burimeve të duhura dhe rekrutimin e punonjësve të kualifikuar;	a.2. K3 2017		a2) Në zhvillim e sipër	a2) E paplotësuar
		a.3. Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të KIESA për dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve;	a.3. K3 2017		a3) Në zhvillim e sipër	a3) E paplotësuar
		a.4. Themelimi i Bordit Këshillues në kuadër të KIESA me pjesëmarrjen e komunitetit biznesor dhe përfshirjen e fuqishme të Zyrës së Kryeministrit;	a.4. K3 2017		a4) Në zhvillim e sipër	a4) E paplotësuar
		b.1. Përgatitja dhe fillimi i zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët;	b.1. K4 2017		b1) Në zhvillim e sipër	a5) E paplotësuar

Gjendja për periudhën K1 – K2

a.1. Projekti i BE-së në MTI "ICEP" gjatë vitit 2016 ka bërë një analizë të detajuar të KIESA-s në përgjithësi dhe analizë krahasuese me agjencitë konkurrencte në rajon në veçanti. Ky raport është dorëzuar në KIESA dhe Kabinetin e Ministrit të MTI-së në dhjetor 2016 duke rekomanduar një strukturë të re për KIESA-n me funksione të reja, ngritje të fuqisë administrative dhe burimeve financiare e njerëzore. Mirëpo, ministri nuk ka ndërmarrë ndonjë vendim gjatë asaj kohe.

a.2. Është përpiluar analiza e KIESA-së dhe analiza krahasuese në mes të KIESA-së dhe agjencive konkurruese në regjion nga projekti i Zyrës së BE-së në Kosovë "Increased Competitiveness and Export Promotion" në dhjetor 2016. Në bazë të kësaj analize ICEP ka përpiluar edhe një propozim të detajuar për Ministrin e MTI-së dhe Qeverinë për fuqizimin dhe restrukturimin e KIESA-së. Dokumenti është në shqyrtim e sipër nga MTI dhe Qeveria.

a.3. Projekti "ICEP" do të ndihmojë në dizajnimin dhe zbatimin e shërbimeve dhe programeve sapo të ketë një vendim më të qartë mbi strukturën e KIESA-s, e cila dikton shërbimet dhe programet që ofron.

a.4. Me datë 23 Shkurt 2017, është përpiluar draft-lista e anëtarëve të: 1) Team Kosova dhe 2) Bordit (këshillit) Konsultativ të KIESA-s; aktualisht është në proces të

vlërësimit dhe aprovimit.

b.1. Agjencioni për Përkrahjen e ndermarrjeve dhe Investimeve ne Kosove - KIESA përmes burimeve njerëzore ekzistuese ofron maksimumin e mundur të shërbimeve **aftercare** për IHD-të ekzistuese në Kosovë. Në kuadër të përkujdesjes ndaj investitorëve të huaj janë kontaktuar 40 kompani të huaja të cilat janë njoftuar për shërbimet përkrahëse që ofron Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve KIESA dhe janë vizituar 10 kompani të huaja. Deri me tani për këtë periudhë KIESA ka bashkëpunuar ngushtë me 18 kompani të cilat janë në proces të investimit apo kanë realizuar investime dhe janë përkrahur direkt nga KIESA. Gjatë periudhës raportuese janë regjistruar 15 investitore në softuerin e KIESA-së.

Gjendja për periudhën K2 – K4

Çdo gjë është e lidhur me vendimin e ministrit të MTI-së për strukturën e KIESA-së, andaj, pasi që aktualisht nuk ka ndonjë vendim nga ministri të gjitha objektivat e parapara të realizohen për këtë masë kanë ngecje.

Po ashtu, pritet miratimi draft-lista e anëtarëve të: 1) Team Kosova dhe 2) Bordit (këshillit) Konsultativ të KIESA-s; aktualisht është në proces të vlerësimit dhe aprovimit.

2.2	<p>Përmirësimi i mjedisit biznesor</p> <p>a.Fokusimi në përmirësimin e treguesve të raportit “Të të bërit biznes” të Bankës Botërore</p> <p>b.Harmonizoni rregullat me standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar</p> <p>c.Reduktimi i barrës rregullative ndaj firmave, në veçanti përmes bërjes transparente të tarifave</p> <p>d.Prezantimi i ndryshimeve legislative për të përmirësuar menaxhimin, koordinimin dhe zbatimin e mbikëqyrjes së tregut</p> <p>e.Përafrimi i legjislacionit, përmirësimi i</p>	<p>a.1. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik lehtëson reformën e të bërit biznes duke u fokusuar në rezultatet dhe arritjet në takimet e saj të rregullta;</p> <p>a.2. Përmirësimi i renditjes për zgjidhjen e paaftësisë paguese nëpërmjet zbatimit efikas të kornizës ligjore për falimentimin;</p> <p>a.3. Shkurtimi i procedurave, kohës dhe kostos për marrjen e lejeve ndërtimore, përfshirë nëpërmjet ndryshimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2013 për Përcaktimin e Procedurave për Dorëzimin dhe Shqyrtimin e Kërkesave për Kushte Ndërtimore si dhe për Leje ndërtimore në K2 2017;</p> <p>a.4. Regjistrimi online i bizneseve është vënë në dispozicion;</p>	<p>a.1. 2016/2017</p> <p>a.2. K4 2017</p> <p>a.3. K4 2017</p> <p>a.4. K2</p>	<p>MTI MMPH MF KGJK</p>	<p>a 1) Në zhvillim e sipër</p>	<p>a 1) Pjesërisht e plotësuar</p>	<p>a2) Në zhvillim e sipër</p>	<p>a 1) Pjesërisht e plotësuar</p>	<p>a3) E plotësuar</p>	<p>a4) E plotësuar</p>
------------	--	---	--	-------------------------------------	---------------------------------	------------------------------------	--------------------------------	------------------------------------	------------------------	------------------------

kapaciteteve të Organeve të Konkurrencës dhe Ndhmës Shtetërore dhe sigurohet që fillojnë zbatimin e mandatit të tyre	a.5. Numri biznesor është unifikuar;	2017; a.5. K4 2017	a5) E plotësuar	
	b.1. Ligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i hartuar;	b.1. K4 2016	b1) Pjesërisht e plotësuar	
	b.2. Konsultimet publike me Shoqërinë Civile dhe partnerët zhvillimor, të mbajtura;	b.2. K4 2016	b2) E paplotësuar	b2) E plotësuar
	b.3. Ligji, i miratuar nga Kuvendi;	b.3. K1 2017	b3) Pjesërisht e plotësuar	b3) E paplotësuar
	c.1. Ligji i ri për shoqëritë tregtare është konsultuar me shoqërinë civile dhe akterët relevantë dhe është miratuar;	c.1. K2 2017	c1) Pjesërisht e plotësuar	
	c.2. Legjislacioni sekondar i ligjit për shoqëritë tregtare, i miratuar;	c.2. K4 2017	c2) Në zhvillim e sipër	c2) E pa plotësuar
	c.3. Regjistri Qendror Online për Licenca dhe Leje është përditësuar më tej, përfshirë tarifatat dhe procedurat e	c.3. K3 2017		

	<p>kërkuara për marrjen e lejeve dhe ngarkimi i formularëve të aplikimit në bazën e të dhënave;</p> <p>d.1. Ligji për inspektimet e përgjithshme i hartuar për të reformuar aspektet kryesore procedurale, institucionale dhe funksionale</p> <p>d.2 Konsultimet publike me shoqërinë civile dhe akterët tjerë relevant, të mbajtura;</p> <p>d.3. Ligji për inspektimet e përgjithshme, i miratuar;</p> <p>e.1. Fuqizimi i procedurave dhe kapaciteteve të brendshme në Autoritetin Kosovar të Konkurrencës për realizimin e hetimeve</p> <p>e.2. Autoriteti i Konkurrencës duhet të hulumtojë dhe përgatis një raport mbi gjendjen aktuale të monopoleve në tregun në Kosovë, me rekomandimet e duhura</p> <p>e.3. Përafrohet dhe ndryshohet ligji për ndihmë shtetërore dhe përafrohet legjislacioni sekondar</p>	<p>d.1. K3 2017</p> <p>d.2. K3 2017</p> <p>d.3. K4 2017</p> <p>e.1. K4 2016</p> <p>e.2. K4 2017</p> <p>e.3. K1 2017</p>		c3) Në zhvillim e sipër	c3) Pjesërisht e plotësuar
				d1) Në zhvillim e sipër	d1) Pjesërisht e plotësuar
				d2) Në zhvillim e sipër	d2) Pjesërisht e plotësuar
				d3) Në zhvillim e sipër	c1) E pa plotësuar
				e1) E paplotësuar	e1) Pjesërisht e plotësuar
				e2) Në zhvillim e sipër	e2) E plotësuar
				e3) E plotësuar	

e.4. Siguroni pavarësinë operative dhe kapacitete të mjaftueshme për të përmirësuar efikasitetin e kontrollit të tij në ndihmën shtetërore

e.4. K1
2017

e4) E plotësuar

Gjendja për periudhën K1 – K2

a.1. Gjatë këtij mandati qeverisës KKZHE ka mbajtur shtatë (7) takime plenare si dhe një numër të konsiderueshëm takimesh të grupeve punuese. KKZHE si platforma më e rëndësishme e dialogut publik-privat ka diskutuar çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit, si MSA, Raportin e Bankës Botërore për të Bërit Biznes, adresimi i shumë kërkesave të ardhura nga komuniteti i biznesit në funksion të mënjanimin të barrierave dhe byrokracisë së panevojshme e çështje të tjera dhe ka marrë një sërë vendimesh me interes për përmirësimin e klimës së të bërit biznes.

a.2. E paraparë të realizohet në K4.

a.3. Me datë 23.05.2017, është miratuar plotësim-ndryshimi i UA nr.10/2013 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe për leje ndërtimore, me nr. 06/2017.

a.4. Procesi është kompletuar gjatë Marsit 2017.

Regjistrimi online fillestar i bizneseve është funksionalizuar dhe qysh nga Marsi i 2017 bizneset kanë mundësi që të dorëzojnë aplikacionet dhe të gjitha dokumentet përcjellëse për regjistrimin fillestar të Biznesit tek ARBK-ja. Regjistrimi online është testuar dhe është funksional për përdoruesit në çdo kohë. Ekziston po ashtu manuali për mënyrën e përdorimit të ëtij sistemi, në të tri gjuhët zyrtare të Kosovës.

a.5. Procesi është kompletuar gjatë Marsit 2017.

MTI, si rezultat i bashkëpunimit të suksesshëm me ARBK-në, ATK-në dhe Doganat ka arritur unifikimin e regjitrimit të bizneseve. Aktualisht bizneset marrin “Numrin Unik të Regjistrimit(NUR-in)” me rastin e regjistrimit në ARBK. Ky numër është unik dhe shërben si mënyra më e lehtë dhe më e mirë që bizneset të komunikojnë me institucionet qeveritare (ATK, Dogana, etj). NA periudha Mars – Dhjetor, të viti 2017, janë inkorporuar në regjistrin e bizneseve në ARBK rreth 6,467 biznese (të pajisura me NUR).

b.1/ b.2/b.3/ Ligji është parashikuar të miratohet nga Kuvendi në tremujorin e parë 2017 mirëpo është shtyrë për tremujorin e tretë 2017. Momentalisht ligji gjendet në Ministri të Financave dhe ende nuk është proceduar për konsultime publike. Ligji për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin do të transpozohet në sistemin ligjor të Kosovës direktivat 2013/34/EU, 2006/43/EC dhe Direktivën 2014/56/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

c.1. Projektligji për Shoqëritë Tregtare është aprovuar në Qeveri me datë 14.03.2017, projektligji tani gjendet në komision parlamentar dhe është miratuar në leximin e parë.

c.2. Hartimi i legjislacionit sekondar pritet të filloj pasi që të miratohet Ligji për shoqëritë tregtare në Parlament.

c.3. MTI është në komunikim me ZKM në mënyrë që të fillojmë procesin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së kësaj platforme nga MTI. Transferi i kësaj kompetence do të bëhet përmes vendimit të Qeverisë.

d.1/d.2/ Me datën 22 Mars 2017 është marrë vendimi i qeverisë për formimin e grupit punues ndërmësor për hartimin e koncept dokumentit dhe Projektligjit për Inspektimet. Koncept dokumenti është finalizuar dhe së shpejti pritet të dalë në diskutim publik. Pasi të aprovohet koncept dokumenti për inspektimet do të fillon hartimi i projektligjit për inspektimet e përgjithshme.

d.3. Ligji nuk parashihet të miratohet gjatë vitit 2017.

e.1. Kapcitetet njerëzore nuk janë rritur edhe përkundër kërkesave të shumta të AKK-së.

e.2. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për këto çështje ka hartuar një strategji për zbatimin e obligimeve që dalin nga ERA, të njejtën është duke e zbatuar dhe në afatin e paraparë që është në tremujorin e fundit të 2017 do të përgadisë raportin mbi gjendjen e monopoleve në KS dhe me rekomandimet e duhura rreth kësaj çështjeje.

e.3. Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për Ndhimën Shtetërore më 25.05.2016. Pas kësaj ligji është dërguar në Kuvend për procedurë të mëtutjeshme. Më datën 23.12.2016 Ligji është miratuar në Kuvend dhe është paraparë të hyjë në fuqi në pjesën e dytë të janarit 2017, pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Ligji për Ndhimën Shtetërore pas dekretimit nga Presidenti, është publikuar në Gazetën Zyrtare më 17 janar 2017.

e.4. Ligji për Ndhimën Shtetërore parasheh që Komisioni i Ndhimës Shtetërore të përbëhet nga pesë (5) anëtarë, ekspërtë të pavarur në fushën e ndihmës shtetërore me mandat trevjeçar

Gjendja për periudhën K3– K4

a.1. Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik është rifunksionalizuar dhe ka mbajtur një takim në dhjetor të 2017. Në atë mbledhje janë diskutuar çështje të rëndësishme, si MSA-ja, Raporti i Bankës Botërore it ë Bërit Biznes, kërkesa të pranuar nga komuniteti i biznesit në funksion të mënjanimite të barriereave në të bërit biznes.

a.2. Deri në periudhën monitoruese rreth 10 raste të bankrotimit janë hapur në Departamentin për çështje Ekonomike. Katë raste janë përmbyllur dhe rastet tjera janë ende në proces. Akademia e Drejtësië ka trajnuar 8 gjykatës dhe 9 bashkëpunëtorë profesional për ndryshimet e reja në Ligjin për Bankrotim dhe Ligjin për Organizimin e Bizneseve.

a.3. Me të hyrë në fuqi të këtij UA, ai zbatohet dhe procedurat e marrjes së kushteve dhe lejeve ndërtimore janë shkurtuar. Kjo gjë ka ndikuar edhe në përmirësimin e pozites në ranglistën e Bankës Botërore për bërje të bizneseve për & vende nga pozita 129 në pozitën 122.

b1/b2/ b3. Projektligji për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim është miratuar nga Qeveria në mbledhjen e 15 Dhjetorit 2017. Projektligji rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të shoqërive tregtare. Gjithashtu rregullon kompetencat dhe përgjegjësit e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar, kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilist profesional, licencimin e auditorëve dhe të firmave vendore dhe të huaja të auditimit si dhe organizatat profesionale të kontabilitetit.

c.1. Projektligji për Shoqëritë Tregtare është aprovuar në Qeveri me datë 20.10.2017. Ligji i Ri për Shoqëritë Tregtare është aprovuar në Kuvend në lexim të parë.

c.2. Hartimi i legjislacionit sekondar pritet të filloj pasi që të miratohet Ligji për Shoqëritë Tregtare në Parlament.

c.3. Zyra Ligjore e ZKM-së ka funksionalizuar Regjistrin Qendror të Lejeve dhe Licencave, i cili është i qasshëm për të gjithë të interesuarit në linkun si në vijim: <https://lejelicenca.rks-gov.net>. Me qëllim të realizimit të këtij procesi me mbështetje nga Projekti “Përmirësimi i Klimës së Investimeve (II) ka angazhuar staf lidhur me azhurnimin e Regjistrin Qendror të lejeve dhe licencave të aplikuara për bizneset nga autoritetet qendrore përmes identifikimit dhe reflektimit të ndryshimeve të fundit në regjistër.

Si rezultat i aktiviteteve të parapara lidhur me azhurnimin e Regjistrin, këto janë ndryshimet fillestare që janë identifikuar:

- Ndryshimet në bazën ligjore – rreth 52% e lejeve dhe licencave kanë kaluar nëpër ndryshime në kuadrin ligjor (d.m.th. Ligjet ose aktet nënligjore janë ndryshuar që nga viti 2015);
- Eliminimi i lejeve/licencave ekzistuese – 45 leje të eliminuara;
- Shtimi i lejeve/licencave të reja – 62 leje/licenca të reja;
- Ndryshimet në afatin që nevojitet për të marrë një përgjigje nga autoriteti që lëshon lejen/licencën – rreth 22% të lejeve/licencave kanë pasur ndryshime në afatin që nevojitet për të marrë lejen/licencën;
- Ndryshimet në tarifën/pagesën e aplikuar - rreth 29% të licencave dhe lejeve kanë pësuar ndryshime në taksën/pagesën e aplikuar;
- Ndryshimet në vlefshmërinë e lejes dhe licencës – rreth 11% të lejeve dhe licencave kanë pasur ndryshime në vlefshmërinë e lejeve/licencave;
- Ndryshimet në informacion të kërkuar (d.m.th. formularin e aplikimit) për dorëzim tek autoriteti që jep lejen/licencën – rreth 16% të lejeve/licencave kanë pasur ndryshime në formular;
- Ndryshimet në dokumentacion të kërkuar për dorëzim tek autoriteti që jep lejen/licencën – rreth 35% të lejeve/licencave kanë pasur ndryshime në dokumentacion të kërkuar për dorëzim tek autoriteti që jep lejen/licencën.

Aktivitetet që pritet të realizohen:

- Dërgimi i të gjithë formularëve për leje/licenca për përkthim në gjuhën angleze dhe serbe;
- Pasi janë pranuar kredencialet për qasje në e – regjistër, së shpejti do të filloj bërja e ndryshimeve direkt në regjistrin elektronik sipas pyetësorit për mbledhjen e informacionit për leje/licenca;
- Vendosja e lejeve/licencave të reja në regjistrin elektronik sipas pyetësorit për mbledhjen e informacionit mbi leje/licencat;
- Organizimi i ngjarjeve për të promovuar versionin e azhurnuar të regjistrin elektronik.

d.1. / d.2. / d.3. Koncepti i dokumentit të Ligjit për Inspektim ka kaluar në diskutim publik, pritet të përcillet tek SKQ për aprovim.

e.1. Kërkesa e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për ngritjen e buxhetit në kategoritë ekonomike dhe sidomos në kategorinë “Paga dhe MEditja” ishte e ndërtuar në baza ligjore, finaciare dhe strategjike. Kjo kërkesë ishte e argumentuar, e arsyeshme dhe në kuadër të mundësive buxhetore. Andaj, kërkesa e tyre është aprovuar nga Komisioni për buxhet dhe financa me pelqimin e Ministrit të Financave. Si rezultat i kësaj, pritet rekrutimi i 7 zyrtarëve për të cilët janë lejuar mjetet. AKK-ja ka plotësuar legjislacionin sekondar si bazament ligjorë për implementimin e metutjeshëm të fuqizimit të procedurave dhe resurseve humane. Aktet nënligjore të cilat AKK-ja ka miratuar janë:

1. Rregullorja nr. 01/2017 për Procedurat hetimore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2017 për Përfundimin Grupor të Marrëveshjeve Horizontale Ndërmjet Ndërmarrësve
3. Udhëzimi Administrativ Nr.03/2017 për Përfundimet Grupore të Marrëveshjeve Vertikale të Ndërmarrësve
4. Udhëzimi Administrativ Nr.04/2017 për Përfundimet Grupore të Marrëveshjeve në Sektorin e Transportit
5. Udhëzimi Administrativ Nr.05/2017 për Përfundimet Grupore të Marrëveshjeve në Sektorin e Sigurimeve

6. Udhëzimi Administrativ Nr.06/2017 për Përjashtimin Grupor të Marrëveshjeve për Distribimin dhe Servisimin e Automjeteve Motorike

e.2. Ne 6 mujorin e fundit AKK-ja ka bërë hulumtimin dhe identifikimin e monopoleve në Republikën e Kosovës për 14 tregje dhe njëkohësisht ka nxjerr informata mbi strukturën e tregut të ndërmarrjeve dhe pozitën e tyre dominuese të përcaktuar me LIGJIN Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për secilin treg veç e veç i ka paraqitur te gjeturat nga ky hulumtim dhe ka dhënë rekomandimet e duhura për rregullatoret dhe institucionet përkatëse të cilat i rregullojnë këto tregje. Ky raport i'u është dërguar Kuvendit, Qeverisë dhe Komisionit Evropian.

2.3	Zbatimi në mënyrë sistematike i strategjisë dhe planit të veprimit të miratuar për luftimin e ekonomisë joformale	1. Realizohen vlerësime të pavarura sektoriale të rrezikut, duke u fokusuar në sektorët më të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale, krimeve financiare, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit (duke mbuluar aspektin gjinor)	1. K3 2017	MF	Në zhvillim e sipër	Pjesërisht e plotësuar
		2. Rishikohet Plani i Veprimit duke marrë parasysh të gjeturat nga vlerësimi i rrezikut	2. K3 2017		Në zhvillim e sipër	Pjesërisht e plotësuar
		3. Përmirësohet më tej pajtueshmëria tatimore dhe zbatimin në mënyrë që të mbrohet interesi i fiskal i vendit, të sigurohen të drejtat e punonjësve dhe të sigurohet konkurrencë e drejtë në fushën e biznesit.	3. K4 2016 / K4 2017		Në zhvillim e sipër	Pjesërisht e plotësuar
		4. Fuqizohet qasja ndër-institucionale dhe mekanizmat në fushën kundër pastrimit të parave, krimit financiar, financimit të terrorizmit dhe korrupsionit, përfshirë parandalimin, hetimet, vlerësimet dhe operimet (me ndihmën e projektit IPA 2015)	4. K4 2017		Në zhvillim e sipër	Pjesërisht e plotësuar
		5. Raporte të rregullta tremujore, të përgatitura, konsultuara dhe publikuara	5. 2016/2017		Në zhvillim e sipër	Pjesërisht e plotësuar

Gjendja për periudhën K1- K2

1. Me datë 11 Prill 2017 Ministri i Financave Avdullah Hoti ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Zyrën e Bashkimit Evropian për Mbështetjen e mëtutjeshme institucioneve të Kosovës në luftën ndaj krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes janë kryer përgatitjet për iniciimin e procesit për kryerjen e vlerësimit të riskut në sektorët më të cenueshëm ekonomik, si lojërat e fatit dhe OJQ-të. Janë përfunduar shumica e intervistave. Janë në proces analizat dhe vlerësimet e rreziqeve. Grupi punues ka mbajtur mbledhjet e rregullta punuese. Në këtë periudhë

është organizuar dhe mbajtur një puntori me OJQ dhe shoqërin civile në lidhje me përgaditjet për ndërmarrjen e vlerësimit sektorial në sektorin e OJQ-ve. Është themeluar grupi punues dhe janë dërguar pyetësorët që do të paraprijnë fazës së grumbullimit të informatave për hartimin e raportit.

Grupi punues për vlerësimin e riskut në sektorin e OJQ-ve dhe lojërave të fatit është funksionalizuar dhe është kompletuar faza e kryerjes së metodave direkte dhe indirekte për grumbullimin e informacioneve, që duhet t'i paraprijë grumbullimit, përpunimit dhe analizimit të të dhënave me qëllim të arritjes së gjetjeve dhe rekomandimeve. Është vazhduar me grumbullimin e të dhënave nga agjencionet përkatëse që duhet t'i paraprijnë hartimit të raportit për 6-mujorin e parë të vitit 2017. Është iniciuar procesi i vlerësimit të nivelit të ekonomisë joformale ku rezultatet e para për diskutim të brendshëm pritet të jenë në kuartalin e tretë.

Është aktualizuar edhe përditësimi dhe rishqyrtimi i Vlerësimit të rrezikut në sektorin e ndërtimeve dhe patundshmërive, i cili raport pritet të ri-freskohet deri në fund të këtij viti. Është vazhduar me takimet e sekretariatit për bashkërendimin e aktiviteteve me projektin e BE-së për rishikimin e PV dhe Strategjisë.

2. Është mbajtur takimi i sekretariatit dhe përfaqësuesve të projektit të BE-së dhe Këshillit të Evropës për bashkërendimin e aktiviteteve për gjysmë-vjetorin e dytë të vitit 2017 dhe hapat e mëtejshëm në rishikimin dhe hartimin e PV-së dhe Strategjisë.

3. Administrata Tatimore e Kosovës nga 1 Prill 2017 deri më 31 Korrik 2017 ka mbledhur të hyra në vlerë 140,5 milion euro apo 6 milion euro më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Vlen të theksohet se gjatë periudhës raportuese Prill-Korrik 2017 lidhur me mos pajisjen me arka fiskale, janë realizuar 793 vizita tek bizneset e pa fiskalizuar, ku janë shqiptuar gjithsej 242 gjoba në vlerën prej 49,750 euro. Për më shumë janë realizuar 1353 vizita tek bizneset të cilat nuk lëshojnë kupona fiskal, me ç'rast janë shqiptuar 797 gjoba mandatore në shumën prej 179,625 euro. Gjithashtu si rezultat i vizitave të realizuara tek bizneset është arritur që të regjistrohen 366 punëtorë.

Nga 1 Prilli deri më 31 Korrik nga Administrata Tatimore e Kosovës, janë realizuar gjithsej 11,662 vizita tek bizneset nga të gjitha regjionet, që kanë rezultuar me 390 punëtorë të regjistruar, mbi 52 milion euro qarkullim shtesë, janë lëshuar 1905 gjoba mandatore në vlerë prej 447,250 euro, 4.3 milion euro tatim shtesë dhe mbi 1.7 milion euro ulje të kreditimit të TVSH-së. Ndërsa sa i përket kontroleve për këtë periudhë raportuese janë realizuar gjithsej 396 kontrollat, të cilat kanë këto rezultate: rreth 18.5 milionë euro tatim shtesë (ku përfshihet tatimi bazë, interesi dhe ndëshkimi) 5.7 milionë euro kreditim i zbritur dhe 7.4 milion euro humbje të zbritur

4. Pas pranimit në Egmont Group me të drejta të plota, NJIF-K ka marrë pjesë në Takimin e 24 Plenar të Egmontit i cili është mbajtur nga 2 deri 7 Korrik 2017. NJIF-K ka qasje direkte në Egmont Secure WEB për shkëmbimin ndërkombëtar të informatave përmes këtij kanali të sigurt. Numri i kërkesave për bashkëpunim ndërkombëtar tashmë është rritur si rezultat i anëtarësimit. Ka vazhduar çasja ndër-institucionale pas përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve dhe ngritjes së bashkëpunimit. Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta është rritur në vitin 2017 për 118% (288: 2017) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (132: 2016), përderisa NJIF-K ka vazhduar me pranimin e kërkesave për informata, bashkëpunim ndër-institucional dhe ndihmë në zbulimin e rasteve të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave të ndërlidhura penale. Është bërë miratimi i akteve nënligjore, kjo me qëllim të zbatimit të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Në bashkëpunim me Projektin PECK II është organizuar dhe mbajtur punëtorja "Mbështetje bashkëpunimit ndër-institucional në fushën e krimit ekonomik". Në fund të Qershorit, gjithashtu është organizuar dhe mbajtur punëtorja "Shpëlarja e Parave dhe Financimi i Terrorizmit" në bashkëpunim me ICITAP dhe OPDAT. Përderisa në javën e parë të Korrikut është mbajtur Seminari "Fuqizimi i Përgjigjes ndaj Terrorizmit në Pajtueshmëri me Sundimin e Ligjit". Janë ndërmarrë Vlerësime të Rrezikut Sektorialë në sektorët më të cenueshëm të PP/FT, duke përfshirë lojërat e fatit dhe kazinot si dhe OJQ-të.

5. Me rishikim të PV dhe strategjisë do të shikohet një metodë më e përshtatshme e raportimit duke përfshi edhe raportimet 3-mujore- edhe pse nuk ka ndonjë progres të theksuar në raportime 3-mujore, e në veçanti kur indikatorët e performancës janë në nivel vjetor. Raportet vjetore dhe raporti gjysmë-vjetor i 2017 krahas të dhënave vjetore përmbajnë të dhëna mujore të cilat pasqyrojnë progresin mujor. Hartimi i raporteve 3-mujore është frekuencë e shkurtër duke pasur parasysh disponueshmërinë e të dhënave. Andaj, raportet hartohen në frekuencë 6-mujore, dhe raporti i ardhshëm për gjysmë-vjetorin e parë është paraparë të përfshijë edhe të dhënat e rezultateve të aktiviteteve të ndërmarrja gjatë gjashtë-mujorit të parë.

Gjendja për periudhën K3– K4

1. Me date 29 shtator 2017 është publikuar “Vlerësimi i vëllimit të ekonomisë joformale” nga Ministria e Financave dhe Zyra e BE-së në Kosovë, përmes projektit të financuar nga BE-ja “Mbështetja e mëtejme për institucionet e Kosovës në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe ekstremizmit të dhunshëm”. Sipas sektorëve, pikat e nxehta ku ka informalitet në raport paraqitet sektori i bujqësisë, sektori i ndërtimtarisë, sektori i shitjeve me shumicë dhe pakicë, sektori i patundshmërive, sektori i veprimtarive financiare dhe sektori i sigurimeve dhe shërbimeve profesionale. Në këtë publikim është kërkuar që reformat duhet të shtrihen edhe në gjyqësor, në mënyrë që të bëhet më shumë në konfiskimin e pasurive të fituara përmes rrugëve të paligjshme.

Ndërsa në Prill 2017 NJIF-K kishte iniciuar një vlerësim të Rrezikut sipas Sektorit Specifik në Pastrimin e Parasë dhe Financimit. ME 12 Prill pritet të prezantohet draft raporti i vlerësimit së bashku me anekset.

2. Është bërë një vlerësim i nivelit të përgjithshëm të ekonomisë joformale. Më 23.10.2017 u krijua Sekretariati i ri i Grupit të Përhershëm për Parandalimin e Ekonomisë Joformale. Raporti përfundimtar i vlerësimit të ekonomisë joformale së bashku me vlerësimet e rrezikut do të shërbejë për hartimin e strategjisë së re për luftimin e ekonomisë joformale dhe pastrimin e parave 2019-2024. Shqyrtimi pritet të bëhet gjatë vitit 2018.

3. Si rezultat nga vëllimi i publikuar thuhet se duke u nisur nga perspektiva e punësimit raporti pasqyron gjendjen e terrenit duke vlerësuar se 45 mijë punëtorë punojnë me orar të plotë në sektorin joformal ku 11 deri në 15% janë në sektorin e bujqësisë, e pasuar nga sektori i ndërtimtarisë dhe në fund veprimtaritë tregtare. Sipas llogaritjeve del se Kosova ka humbje prej 60.1 milionë euro në vit nga mospagesa e Tatimit në të ardhura personale dhe tatimi në të ardhura të korporatave.

Duke e ditur se shumica e bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë janë biznese familjare, sipas raportit kjo situatë tregon se 33.2% e të ardhurave personale për ekonominë familjare janë joformale. Këtë shifër e dëshmon fakti se e ardhura totale sipas konsumit nuk përputhet me asnjë burim të njohur të ligjshëm dhe ka gjasë se kjo e ardhur të jetë krijuar nga veprimtaritë që mbahen të fshehura në mënyrë të përhershme.

Me date 29 shtator 2017 ministri Bedri Hamza bëri të ditur se ka marrë vendim që ti përcjell në Qeveri Vendimet dhe Udhëzimet Administrative dhe duke filluar nga data 01 janar 2018, të gjithë prodhuesit të cilët importojnë vet apo përmes kontraktorëve do të lirohen nga Tatimi doganor, për lëndën e parë, gjysëm produktin, linjat e prodhimit, pajisjet e teknologjisë informative si dhe më pas do të lirohen nga Tatimi i akcizës të gjitha produktet të cilat marrin pjesë si lëndë ndihmëse në procesin e prodhimit. Lirimet nga tatimi doganor për të gjithë prodhuesit e vendit tonë të cilët janë të autorizuar nga Administrata Tatimore e Kosovës për të drejtën e shtyrjes së TVSH-së do ta ndihmojnë zhvillimin e sektorit privat, përkatësisht prodhuesve brenda vendit tonë dhe të gjithë atyre që vijnë për të investuar në vendin tonë.

Të gjitha lirimet nga tatimi doganor dhe akciza kanë të bëjnë me fushën e ndihmës së prodhimtarisë me këtë rast: Është liruar nga tatimi doganor lënda e parë që shfrytëzohet në proces të prodhimit; Lirohen nga tatimi doganor gjysmë produktet të cilat përdoren në proces të prodhimit; Lirohen nga tatimi doganor të gjitha linjat e makinerive prodhuese të cilat përdoren në hapësira prodhuese për prodhim; Lirohen nga tatimi doganor pajisjet e teknologjisë së informacionit; Lirohen nga tatimi i akcizës të gjithë prodhuesit pavarësisht se a importojnë vetë apo përmes kontraktorëve për të gjitha burimet e energjisë të cilat përdoren si lëndëndihmëse në procesin e prodhimit siç janë; Mazuti; Gazi; Nafta; Do ti propozohet Qeverisë të aprovoj Udhëzimin Administrativ për shënjimin e miellit, i cili vendoset në qarkullim të lirë në tregun e Republikës së Kosovës.

Sipas ministrit Bedri Hamza, ky është hapi i parë i masave të politikës fiskale të cilat janë harmonizuar edhe me kërkesat e biznesit. “Të gjitha këto masa të liritimit nga tatimi doganor dhe tatimi i akcizës do ta ndihmojnë prodhimtarinë e vendit tonë dhe do të na bëjnë një treg më atraktiv për investime të huaja”.

4. Pas pranimit në Egmont Group, NJIF ka qasje të drejtpërdrejtë në Egmont Secure WEB për shkëmbimin ndërkombëtar të informacionit nëpërmjet këtij kanali të sigurt. Të dhënat tregojnë një rritje prej 90% në shkëmbimin dhe ndarjen spontane të informacionit me NJIF-të homologe. Kjo gjithashtu ka kontribuar në anëtarësimin në Egmont dhe qasjen në ESW.

- Janë kryer 264 intervista me të dyshuarit dhe dëshmitarët. Aktivitete të tjera përfshijnë: 358 takime dhe konsultime me prokurorët; 32 raste ishin iniciuar nën dyshimin për shmangie nga tatami; 5 bastisje - inspektime për shmangie nga tatami; 21 raporte përfundimtare hetuese janë dorëzuar për ngritjen e aktakuzave për veprën penale të shmangies nga tatimi, në shumën 667.014 euro, pa ndëshkime dhe interes.
- Numri i informatave të këmbyerë të inteligjencës është gjithsej 221, nga të cilat 134 informata për NJIF, 43 informata për Policinë e Kosovës, 34 informata për Doganën e Kosovës dhe 10 prej tyre ishin të institucioneve të ndryshme, 83 raporte u dërguan në prokurori
- Në kuadër të bashkëpunimit institucional për zbatim të ligjit, asistencë është ofruar në gjithsej 28 kontrole/bastisje, prej të cilave, 16 bastisje janë realizuar me Policinë e Kosovës dhe 12 bastisje me Doganën e Kosovës.
- Zbatimi i mekanizmave të përbashkët të shkëmbimit të informacionit ka vazhduar ndërmjet agjencive përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar. Ka pasur një rritje prej 23% në numrin e kërkesave për informacion krahasuar me vitin paraprak.
- Në vitin 2017, NJIF-K kreu 17 inspektime në vend dhe në terren në lidhje me përmbushjen e obligimeve.
- Në 2017, NJIF-K ka pranuar 109 reagime kthyes nga institucione të tjera, përfshirë Policinë, ATK-në dhe Doganën. Kjo pritet të ketë efekte pozitive në rritjen e cilësisë së analizës. Si rezultat i punës së përbashkët ndërinstitucionale, NJIF-K ka lëshuar tri udhëzime për ngrirjen e përkohshme të transaksionit duke ngrirë përkohësisht 1 milion euro të cilat dyshohet se janë fituar ilegalisht

5. Nuk ka informata për ndryshime nga periudha e parë 6 mujore 2017. Për shkak të vëllimit të institucioneve për zbatimin e ligjit si dhe disponueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave, tani për tani mund të raportohet vetëm për periudhë gjashtëmujore. Raporti vjetor për 2017 pritet të finalizohet në fund të tremujorit të dytë të vitit 2018.

2.4	Mbështetja e zhvillimit të NVM-ve	a.1. Struktura e koordinimit të ABV është themeluar, përfshirë pikat e kontaktit për secilën ministri;	a.1. K4 2016	MTI	a 1) Pjesërisht e plotësuar	
	a) Ndërmarrja e masave pasuese bazuar në rekomandimet e vlerësimit rreth "Aktit të Bizneseve të Vogël"	a.2. KIESA fuqizon përpjekjet e gjera koordinuese të qeverisë për zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi i Aktit të Bizneseve të Vogla, përfshirë nëpërmjet takimeve të rregullta koordinuese	a.2. K4 2017		a2) Në zhvillim e sipër	a2) Pjesërisht e plotësuar
	b) Miratimi i masave konkrete për të përmirësuar infrastrukturën dhe standardet e cilësisë	b.1. Avancimi dhe përditësimi i rregullt i uebfaqes, për tu përdorur si një platformë informuese online për bizneset, përfshirë këtu dhe infrastrukturën e cilësisë.	b.1. K4 2017		b 1) Në zhvillim e sipër	b 1) E plotësuar Në realizim vazhdimisht

	<p>c) Prezantimi i programeve dhe instrumenteve të eksportit për ndihmuar që NMV-të të integrohen në zinxhirët global të vlerës, me qëllim të mbështetjes së ndërkombëtarizimit të tyre</p>	<p>b.2. 10 punëtori, të organizuara me qëllim të informimit të bizneseve sa i përket infrastrukturës së cilësisë dhe detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni specifik vertikal, përfshirë këtu dhe promovimin e uebfaqes si platformë informuese.</p>	b.2. 2016/2017		b2) Në zhvillim e sipër	b2) Pjesërisht e plotësuar
		<p>b.3. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore në fushën e infrastrukturës së cilësisë, duke përfshirë mënyrën nëpërmjet trajnimit të stafit (organizimi i 30 moduleve të trajnimit) dhe organeve të vlerësimit të konformitetit.</p>	b.3. K4 2017		b3) Në zhvillim e sipër	b3) Pjesërisht e plotësuar
		<p>b.4. 1,500 standarde, të miratuara me fokus në zonën e harmonizuar.</p>	b.4. K4 2017		b4) Në zhvillim e sipër	b4) Pjesërisht e plotësuar
		<p>b.5. Laboratorët metrologjik ekzistues, të furnizuar me pajisje;</p>	b.5. K4 2017		b5) Në zhvillim e sipër	b5) E plotësuar
		<p>b.6. Ligji mbi shërbime, i hartuar dhe konsultuar me shoqërinë civile dhe akterë tjerë relevant.</p>	b.6. K1 2017		b6) E plotësuar	
		<p>b.7. Ligji mbi shërbime, i miratuar (transpozimi i pjeshëm i Direktivës 123/EC mbi shërbime);</p>	b.7. K2 2017		b7) E plotësuar	
		<p>b.8. Pika e vetme e kontaktit për shërbime, e themeluar dhe funksionale</p>	b.8. K4 2017		b8) Në zhvillim e sipër	b8) Pjesërisht e plotësuar
		<p>c.1. Bizneset, të mbështetura për të rritur konformitetin e produktit të tyre (certifikimi i produktit) dhe ndërkombëtarizimin e tyre.</p>	c.1. K4 2017		c1) Në zhvillim e sipër	c1) Pjesërisht e plotësuar

d) Miratimi i masave për të thelluar dhe zgjeruar ndërmjetësimin financiar me qëllim të rritjes së qasjes së NMV-ve në financa	c.2. Kosova i bashkohet Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve		c2) Në zhvillim e sipër	c2) Pjesërisht e plotësuar
	c.3. Kosova merr pjesë në programin COSME për mbështetjen e NVM-ve në lehtësimin e qasjes në financa, përmirësimin e qasjes në tregje dhe rritjes së konkurrencës dhe kulturës ndërmarrëse	c.2. K3 2017	c3) Në zhvillim e sipër	c3) Pjesërisht e plotësuar
	d.1 Miratimi i ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare	c.3. K3 2017	d1) Në zhvillim e sipër	d1) E paplotësuar
	d.2. Futja në funksion e Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive (FKGK)	d.1. K3 2017	d2) E plotësuar	

Gjendja për periudhën K1- K2

a.1. ZKM ka caktuar organet qeveritare si organet kresore përgjegjëse dhe ka krijuar pikat e kontakteve për secilen nga prioritetet e Bizneseve të Vogla.

a.2. E paraparë të realizohet në K4 2017.

b.1. E paraparë të realizohet në K4 2017.

b.2. Në muajin Prill është mbajtur tryeza me bizneset ku kanë marrë pjesë 33 pjesëmarrës në fushën e zbatimit të legjislacionit për ashensorë dhe komponentet e sigurisë; poashtu e mbështetur nga TAIEX është mbajtur një punëtori për harmonizimin e legjislacionit horizontal për lëvizjen e lirë të mallrave. Me 25 maj 2017 është shënuar dita botërore e Metrologjisë.

b.3. E paraparë të realizohet në K4 2017.

b.4. E paraparë të realizohet në K4 2017.

Gjate K1 janë adoptuar 17 standarde në fushën e teknologjisë informative, ndërsa 143 standarde të sektorit të përpunimit të drurit gjinden në diskutim publik. Gjate K2 janë adoptuar 143 standarde (sektori i përpunimit të drurit), ndërsa në diskutim publik janë 250 standarde (34 për metrologji; 82 për tekstil dhe lëkurë këpucë; 39 për teknologji agroushqimore; dhe 95 për makineri). 1.500 standarde është numri total që parashihen të adoptohen gjate tere vitit 2017.

b.5. E paraparë të realizohet në K4 2017. Është proceduar kërkesa për furnizim me pajisje shtesë për laboratorët e AMK-së, kanë përfunduar të gjitha procedurat, ka mbetur vetëm të nënshkruhet kontrata.

b.6. Ligji është miratuar dhe publikuar në gazetën zyrtare me datë 03.04.2017

b.7. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën 2006/123/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 12 dhjetorit 2006 për Shërbimet në tregun e brendshëm.

b.8. E paraparë të realizohet në K4 2017.

Udhezimi Administrativ për Pikën e Vetme të Kontaktit është duke u hartuar dhe pritet të përfundojë në K3.

c.1. E paraparë të realizohet në K4 2017.

Është mbyllur thirrja për subvencionim të certifikimit të produkteve në të cilën kanë aplikuar 4 kompani. Pas shqyrtimit të dokumentacionit janë shpallë rezultatet preliminare ku është përzgjedhur një kompani.

c.2. E paraparë të realizohet në K3 2017.

c.3. E paraparë të realizohet në K3 2017.

d.1. E paraparë të realizohet në K3 2017.

d.2. Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë është funksionalizuar dhe deri në Qershor 2017 ka lëshuar 328 kredi për bizneset vendore me shumë të aprovuar të kredive prej 14,103,300.00 euro.

Gjendja për përiudhën K3– K4

a.1. Në bazë të vendimit ka përfunduar identifikimi i institucioneve dhe i zyrtarëve të cilët do të jenë pjesë e grupeve punuese për dimensionet 3, 5a, 8a, 10 dhe njëherit janë përgatitur vendimet për këto katër dimensione. Më 12.05.2017 KIESA, bazuar në Vendimin Nr. 02/129 të QRK, ka dërguar shkresa tek institucionet relevante për të kërkuar formimin e grupeve punuese për 12 dimensionet e SBA. Ende mungojnë vendimet për këto grupe dhe institucionet përgjegjëse: Dimensioi 2 MTI, Dimensioi 4 MAP, Dimensioi 5b KRPP, Dimensioi 7 MTI, Dimensioi 9 MMPH.

Edhe përkundër mungesës së nxjerrjes së vendimeve me datë 12.10.2017 është realizuar takimi i planifikuar me OECD ku është prezantuar metodologjia dhe procesi i vlerësimit të indeksit të politikave të NVM-ve. Janë realizuar takime bilaterale me të OECD-së me grupe punuese për secilin dimension.

a.2. Pas vendimeve për formimin e grupeve punuese KIESA është duke e koordinuar punën e të gjitha institucioneve në zbatimin e rekomandimeve dhe parimeve të SBA. Është shpërndarë pyetori tek të gjithë kryesuesit dhe anetarët e grupeve punuese dhe ka filluar plotësimin e pyetorit i cili duhet të finalizohet deri ka mesi i muajit Janar. Me datë 06.12.2017 është mbajtur punëtorja një ditore në Prishtinë lidhur me plotësimin e plotë të pyetorit të dimensionit të parë të Aktit të Biznesit të Vogël. Punëtorja është mbështetur nga European Training Foundation (ETF). Me datë 13.12.2017 në zyret e KIESA-së është mbajtur takimi për finalizim të pyetorit të OECD-së ku është punuar në finalizimin e dimensioneve 5a, 8a dhe 10 të cilat i takojnë MTI-së. KIESA po udhëheq procesin e finalizimit të vlerësimit të SBA, i cili është paraparë të përfundojë deri në mes të shkurtit.

b.1. Web faqja është duke u rifreskuar më të dhëna të reja në baza ditore.

b.2. Në muajin Maj në takim me bizneset e ftuara nga Oda Ekonomike Kosovare, Kryeshefi i Agjencisë Kosovare të Standardizimit ka mbajtur prezantimin “Standardizimi në funksion të certifikimit”. Takime tjera të mbajtura:

- (18.07.2017) Divizioni i Infrastrukturës së Cilësisë ka organizuar takimin me biznese ku është diskutuar implementimi i legjislacionit për fushën e ashensorëve.
- (18.07.2017) Takim me operatorët ekonomik (Instalues të Ashensorëve) ku është diskutuar në lidhje me draftin final të Rregullores për Sigurinë e ashensorëve në Përdorim.
- (10.08.2017) Takim me operatorët ekonomik (trupat inspektuese të autorizuar nga MTI) në lidhje me hartimin dhe implementimin e legjislacionit për fushën e ashensorëve, target i të cilit ishin:

- MODULET (Inspektimi Final, Verifikimi i Njesisë dhe Kontrolli Përiodik) të aplikuara nga TVK sipas Rregullores Nr.03/2017 për Sigurinë e Ashensorëve.
- Diskutim në lidhje me draft Rregulloren për Sigurinë e ashensorëve në Përdorim.
- Obligimi për akreditim i Trupave Inspektuese - Përiudha Tranzitore prej një (1) viti.
- Regjistrimi i Ashensorëve të rinjë dhe shpërndarja e numrave identifikues ID.

Agjencia Kosovare për Standardizim ka organizuar takim me rastin e Ditës Botërore të Standardeve më 16 tetor 2017.

b.3. Nga Qershori deri në Dhjetorë janë mbajtur 7 trajnime, 3 punëtori, 1 takim dhe 1 vizitë studimore, të cilat janë të identifikura më poshtë:

- (13 - 16 shtator 2017) Mekanizmat e monitorimit dhe komunikimit në aktivitetet e Mbikëqyrjes së Tregut në sektorin e pajisjeve elektrike dhe elektronike EEE me mbështetjen e projektit të SIDA –Infrastruktura e Cilësisë në Ballkanin Përendimorë.
- (25-29.09.2017) Çështjet teknike të Mbikëqyrjes së Tregut - Kontrollat në fushën e pajisjeve elektrike dhe elektronike.
- (7 Qershor 2017) Punëtorinë WS6 për Produktet e ndërtimit në Podgoricë - Rregullorja e BE-së 305/2011 CPR: Mbikëqyrja e tregut në fokus.
- (9 Qershor 2017) Punëtorinë WS12 për pajisjet elektrike dhe elektronike – Direktivat për EEE dhe EMC: Mbikëqyrja e tregut në fokus.
- Trajnimi tre ditor në Maj, Transpozimi i Direktivës së peshoreve jo automatike (transpozim i direktivës evropiane NAWI 2014/32), i cili është mbajtur në Bruksel.
- (13 deri 15.06.2017) Transpozimi i MID Direktivës (Direktivës Evropiane për Instrumente Matëse MID 2014/32), mbajtur në Bruksel.
- (06.06.2017) Promovimi i metrologjisë, organizuar nga projekti SIDA, mbajtur në Podgoricë.
- (26-28.06.2017) PT testet, mbajtur në Berlin.
- (13-15.06.2017) Aplikimi në praktike të sistemeve të ICSMS dhe RAPEX-it.
- (25-28.10.2017) Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ RIA në lidhje me hartimin e strategjive dhe legjislacionit, mbajtur në Berlin.
- (31.10-02.11.2017) Sfidat dhe mundësitë në fushën e EEE (Electric and Electronic Equipment) i cili është mbajtur në Beograd.
- (07-10.11.2017) Vizitë studimore në Slloveni për trupat për vlerësim të konformitetit të autorizuara nga MTI për inspektimin e ashensorëve.

b.4. Gjatë vitit 2017, Komitete Teknike kanë identifikuar gjithsejtë 647 standarde evropiane EN dhe ndërkombëtare ISO/IEC, të cilat janë adoptuar si standarde kosovare SK: KT për Energji (107 SK); KT për Makineri (95 SK); KT për Metrologji (34 SK); KT për Shëndetësi (111 SK); KT për Miniera dhe Minerale (22 SK); KT për Përpunimin e Drurit (143 SK); KT për Teknologji Informative (17 SK); KT për Teknologji Agroushqimore (36 SK); KT për Tekstil dhe Lëkurë Këpucë (82 SK);

Ndërsa Komiteti Teknik për Mjedis ka përgatitur në listë me 167 standarde për shqyrtim, dhe si të tilla do të hyjnë në diskutim publik për afatin prej 60 ditëve deri në adoptimin final.

b.5. Ka përfunduar furnizimi me pajisje për 5 laboratorë, për laboratorin e presionit, të metaleve të çmuara, të forcës dhe të laboratorit për matjen e temperaturës dhe lagështisë relative dhe për laboratorin e kohës dhe frekuencës.

b.6. Ky aktivitet ka përfunduar në Dhjetor 2016.

b.7. Ligji për Shërbime është aprovuar me 10 Mars nga Kuvendi i Kosovës dhe me 3 Prill është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

b.8. Udhëzimi Administrativ për Mënyrën e Funkcionimit të Pikës së Vetme të Kontaktit është hartuar dhe ka përfunduar konsultimi paraprak dhe publik. U.A. është proceduar

me datën 22.01.2017 në Qeveri për aprovim.

c.1. KIESA gjatë vitit 2017 ka realizuar dy shpallje, një për skemën vaucher të këshillimeve ku nuk është përzgjedhur asnjë kompani dhe e dyta për subvencionim 50% të kostos së çertifikimit të produkteve të gatshme për eksport. Për subvencionim të çertifikimit të produkteve kanë aplikuar 4 kompani. Pas shqyrtimit të dokumentacionit janë shpallë rezultatet preliminare ku është përzgjedhur një kompani e cila nuk i ka respektuar afatet kohore të marrëveshjes për çertifikim të produkteve dhe nuk është rimbursuar.

c.2. dhe c.3. Qeveria E Kosovës ka dhënë pëlqimin për Marrëveshjen COSME dhe ka mandatuar Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për të negociuar dhe për të finalizuar marrëveshjen. Marrëveshja është nënshkruar në Bruksel nga Ministri i MTI-së z. Bajram Hasani me datën 19.12.2017, pjesë e të cilit është Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve (EEN).

d.1. Drafti i projektligjit është në konsultim publik.

d.2. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është funksionalizuar dhe deri në Nentor 2017 ka aprovuar 677 kredi për bizneset vendore me shumë të aprovuar të kredive prej 26,239,800 euro.

2.5	Zhvillimi i mëtejshëm i disa statistikave sektoriale, kyçe për politikëbërje në fushën e llogarive kombëtare, statistikave të biznesit, statistikave të energjisë dhe atyre sociale	<p>1.Vonesat e publikimit, të reduktuara për PBB-të vjetore dhe tremujore përkatëse dhe statistikave të llogarive të qeverisë, përfshirë këtu publikimin në kohë të statistikave financiare të qeverisë me metodologjinë e ESA 2010;</p> <p>2.Prodhimi dhe publikimi i statistikave afatshkurtra të biznesit, të përmirësuar (vëllimit të prodhimit industrial dhe indekset e çmimeve);</p> <p>3.Rezultatet nga statistikave të Anketës së Fuqisë Punëtore, të shpërndara në baza tremujore, dhe cilësia e tyre, e përmirësuar;</p> <p>4.Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës, e kryer;</p> <p>5.Publikimi i statistikave të energjisë, të reduktuara dhe statistikave vjetore të efikasitetit të energjisë, të prodhuara në përputhje me standardet ndërkombëtare;</p>	1.K4 2017 për PBB-të tremujore të 2018 për PBB-të dhe SFQ-të vjetore	ASK	1) Në zhvillim e sipër	1) Pjesërisht e plotësuar Në zhvillim e sipër
			2.K4 2017 Indeksi i Prodhimit Industrial		2) Në zhvillim e sipër	2) Pjesërisht e plotësuar Në zhvillim e sipër
			3.K4 2017		3) Në zhvillim e sipër	3) E plotësuar
			4.K4 2017		4) Në zhvillim e sipër	4) Pjesërisht e plotësuar Në zhvillim e sipër
			5.K4 2018		5) Në zhvillim e sipër	5) Pjesërisht e plotësuar Në zhvillim e sipër

Gjendja për periudhën K1– K2

1. Shkurtimi i afateve për publikimin e rezultateve të BPV është prioritet i ASK dhe po zbatohet me përpikëri. Duke filluar nga TM3 2016, BPV në baza kuartale (TM) publikohet rregullisht sipas metodologjisë së ESA2010 dhe sipas kalendarit të Eurostat-it (T+ 90 ditë). Po ashtu edhe afati për publikimin e BPV vjetore është shkurtuar dhe këtë vit ky publikim me të dhënat për vitin 2016, do të jete në tetor. Llogaritë qeveritare tremujore për TM4 2016 janë publikuar për herë të parë në prill 2017. Këto të dhëna publikohen rregullisht sipas standardeve t+30 ditë.

2. Vëllimi i prodhimit industrial dhe indeksat mbeten detyrë për vitin 2018.

3. Gjatë periudhës 1 prill -31 korrik 2017 janë publikuar 3 publikime të AFP-së: TM4 2016, Rezultatet e AFP 2016 (publikimi vjetor) dhe rezultatet e AFP për TM1 2017. Publikimet janë publikuar sipas kohës së paraparë në Kalendarin e Publikimeve të ASK-së, është përgatitur udhëzuesi i AFP-së për anketuesit, është rritur shkalla e monitorimit në terren gjë që ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së të dhënave të AFP-së si dhe janë dërguar të dhënat (micro-data) e AFP-së në Eurostat për TM1 2017 ku do vazhdohet edhe tutje me dërgimin e të dhënave për çdo tremujorë

4. Gjatë periudhës 1 prill -31 korrik 2017 janë zhvilluar këto aktivitete: dizajnimi i pyetësorëve 2017, përgatitja e udhëzuesit (manualit), plani i realizimit të Anketës përmes metodës Capi si dhe planifikimi i kohës dhe resurseve për zhvillimin e anketës në terren. Kjo anketë është planifikuar që të zhvillohet në TM4 2017.

5. Janë inkorporuar të dhënat e anketës së konsumit të energjisë në ekonominë familjare në Bilancin e Energjisë për vitin 2016. Efiçienca e energjisë është akoma në proces.

Gjendja për periudhën K3– K4

1.

a. Publikimi i fundit për BPV në baza tremujore është bërë me datën (28.12.2017) për K3 2017 dhe shkurtimi i afatit kohor në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është një ditë, por është brenda afateve (t+90 ditë).

b. Publikimi i fundit për SFQ në baza tremujore është bërë me datën (29.12.2017) për TM3 2017 sipas standardit (T+90 ditë). Publikimi SFQ në baza tremujore është publikuar për herë të parë në vitin 2017 për K1 K2 dhe K3 2017.

c. Publikimet janë në harmoni të plotë me ESA 2010, ndërsa tani ESA 2010 është zbatuar 36%.

2. Indeksi I Prodhimit Industrial ende nuk është i publikuar, sipas planit është planifikuar të publikohet në Qershor 2018 bashkë me TM1 /2018. Sa i përket indeksit të çmimeve të prodhimit, i fundit është publikuar me 8.12.2017 për TM3 2017.

3. Publikimi i fundit për LFS në baza tremujore është bërë me datën 12/12/2017 për TM3/2017 dhe shkurtimi i afatit kohor në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 44 ditë.

4. Janë përgaditur pyetësorët, udhëzimet/manuallet. Puna në terren parashihet të realizohet në mars – qershor 2018, pastaj, publikimi i të dhënave në vitin 2019.

5. Publikimi i fundit për statistikën e energjisë në baza tremujore është bërë me datën 17.12.2017 për K3 2017 dhe shkurtimi i afatit kohor në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak është 8 ditë, ndërsa për K4 2017, pritet të publikohet me 14 shkurt 2018. Ndërsa, statistikën e efiçencës, për vitet 2011-2016, bëhet me datën 09 Mars 2018 (vetëm për sektorin e Insutrisë dhe ekonominë familjare, ndërsa për sektorin e shërbimeve dhe transportit bëhet në një periudhë tjetër).

2.6	<p>Përmirësimi i lidhjes rajonale</p> <p>a) Zbatimi i projekteve të investimeve publike individuale me prioritet, në veçanti duke miratuar raportin e rishikuar të zbatimit të klauzolës së investimeve, në bazë të "Listës prioritare të projekteve infrastrukturore"</p> <p>b) Zbatimi i të gjitha 'masave të buta' të mbetura të lidhjes, dhe reformat përkatëse të politikave mbi transportin dhe energjinë</p>	<p>a. 1 Qeveria miraton raportin e rishikuar mbi zbatim, për klauzolën e investimeve;</p>	6. a.1. K4 2016	MIE MF	E paplotësuar	Pjesërisht e plotësuar
		<p>a.2. Numri i marrëveshjeve financiare, i ratifikuar në Kuvend në lidhje me projektet brenda Klauzolës së Investimeve, e aprovuar nga KKI dhe Qeveria;</p>	6.a.2. K4 2017		E paplotësuar	Pjesërisht e plotësuar
		<p>Energjia</p> <p>6.b.i. Legjislacioni dytësor që rrjedh nga ai primar, i miratuar;</p> <p>6.b.ii Çmimet e parregulluara të energjisë:</p> <p>1. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së), e ndryshuar dhe miratuar;</p> <p>2. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së), e miratuar;</p> <p>3. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), e miratuar;</p>	6.b.i. K2 2017	MZHE MI ZRRE KOSTT	6bi) Pjesërisht e plotësuar	
		<p>1. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Çmimet e OSSH-së), e ndryshuar dhe miratuar;</p>	6.b.ii. K2 2017		1) E plotësuar	
		<p>2. Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së), e miratuar;</p>			2) E plotësuar	
		<p>3. Rregulla për vendosjen e çmimeve të operatorit të sistemit të transmisionit dhe të tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), e miratuar;</p>			3) E plotësuar	
		<p>6.b.iii. Tregu i përbashkët energjetik me Shqipërinë, i krijuar;</p>	6.b.iii.K4 2016		E paplotësuar	Pjesërisht e plotësuar
		<p>6.b. iv. Tregu i aksioneve energjetike me Shqipërinë - KOSTT (një ditë përpara dhe brenda ditës), i krijuar;</p>	6.b.iv. K4 2016	6biv) E paplotësuar		
		<p>6.b.v. Furnizuesit e rinj të energjisë elektrike, të krijuar;</p>	6.b.v. K4 2016	6bv) E plotësuar		

	6.b.vi. Marrëveshja ndërmjet KOSTT-EMS, e zbatuar	6.b.vi. K4 2016	MI MTI MPB MF	6bvi) E paplotësuar	6bvi) Pjesërisht e plotësuar	
	6.b.vii. Kodi i rrjetit të KOSTT-it, i harmonizuar me atë të ENTSO-E.	6.b.vii. K4 2016		6bvii. E plotësuar		
	Transporti					
	6.b.1. Hapja e tregut të transportit;	6.b.1. K2 2017		6b I. E plotësuar		
	6.b.1.1. Zbatimi i strategjisë së reformës hekurudhore;	6.b.1.1. K2 2017		6b I I. Pjesërisht e plotësuar		
	6.b.2. Krijimi i një sistemi konkurrues, të besueshëm dhe të sigurt sa i përket transportit;	6.b.2. K2 2017		6b2. Pjesërisht e plotësuar		
	6.b.2.1 Përmirësimi i sigurisë në rrugë. Synimi i uljes së objekteve me 20% krahasuar me vitin e referuar 2014;	6.b.2.1 K2 2017		6b2I. E paplotësuar	6b2. Pjesërisht e plotësuar	
	6.b.2.2. Lehtësimi i tregtisë dhe transportit;	6.b.2.2 K2 2017		6b22. Nuk ka informata.	6b2. Pjesërisht e plotësuar	
	6.b.2.3. Vendosja e sistemit inteligjent të transportit (SIT) në Rrjetin Kryesor;	6.b.2.3 K2 2017		6b23. E paplotësuar		
	6.b.2.4. Krijimi i sistemit funksionues të mirëmbajtjes, duke siguruar që asnjë seksion të mos ketë gjendje të keqe/shumë të keqe;	6.b.2.4. K2 2017		6b24. Nuk ka informata.	6b24. E paplotësuar	
	6.b.3 Rritja e efektivitetit të Procedurave të kalimit të kufirit;	6.b.3. K2 2017	6b3. Nuk ka informata.	6b3. Pjesërisht e plotësuar		

	6.b.3.1. Marrëveshjet efektive të kalimit kufitar;	6.b.3.1. K2 2017		6b31. Pjesërisht e plotësuar
	6.b.3.2. Zbatimi i strategjisë për Menaxhimin e integruar të kufirit (MIK)	6.b.3.2. K2 2017		6b32. Pjesërisht e plotësuar

Gjendja për periudhën K1- K2

a1/a2. Nuk ka zhvillime për shkak të zhvillimeve aktuale politike.

ENERGJIA

6.b.i. Tërë legjislacioni dytësorë është harmonizuar sipas Ligjeve primare të energjisë dhe është duke u zbatuar nga prill/maj 2017.

6.b.ii. Në janar të vitit 2017 është lëshuar “Udhëzuesi për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës” i cili e definon mënyrën dhe kohën e liberalizimit të tregut të energjisë, rrjedhimisht edhe të derregullimit të çmimeve me shumicë dhe me pakicë.

Duke filluar nga data 1 prill 2017 çmimet e gjenerimit nga KEK sh.a. janë derregulluar dhe do të përcaktohen në bazë të marrëveshjeve bilateral në mes palëve në treg, duke marrë për bazë çmimet e tregut.

Në aspektin e çmimeve me pakicë, deri më tani janë derregulluar çmimet e konsumatorëve industrial të kyçur në nivelin 220 kV. Ndërsa pjesa tjetër e konsumatorëve ku përfshihen konsumatorët familjar dhe jofamiljar do të vazhdojnë të furnizohen nga Furnizuesi me Shërbim Universal dhe do të derregullohen gradualisht sipas Udhëzuesit për liberalizimin e tregut dhe udhëzimeve tjera të lëshuara nga Bordi I ZRRE-së.

- 1) Më 16 Mars të vitit 2017 është aprovuar “Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të shpërndarjes (Rregulla për Të Hyrat e OSSH-së)” duke u përshtatur me ndryshimet e fundit ligjore. Gjithashtu janë aprovuar edhe “Parimet për Përcaktimin e Çmimeve për Shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes dhe taksat e Kyçjes”
- 2) Nuk ekziston Furnizues Publik, andaj edhe kjo Rregull ka pushuar së aplikuari. Me fillimin e derregullimit të çmimeve me pakicë të energjisë elektrike, më nuk do të ketë vetëm një furnizues në treg (sikur ka qenë Furnizuesi Publik), mirëpo do të ketë numër më të madh të furnizuesve, prandaj me ndryshimet e fundit ligjore është vendosur Obligimi I Shërbimit Publik për furnizimin me Shërbim Universal njërit nga furnizuesit e licencuar në Kosovë, i cili do të furnizojë konsumatorët të cilët sipas ligjit gëzojnë të drejtën e një furnizimi të tillë. Konsumatorët të cilët e gëzojnë këtë të drejtë janë konsumatorët familjar dhe jofamiljar të cilët kanë qarkullim nën 10 milion euro në vit si dhe kanë më pak se 50 punëtorë.
- 3) Më 16 Mars të vitit 2017 është aprovuar “Rregulla për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të operatorit të sistemit të transmetimit dhe tregut (Rregulla për Të Hyrat e OST/OT-së)” duke u përshtatur me ndryshimet e fundit ligjore. Gjithashtu janë aprovuar edhe “Parimet për Përcaktimin e Çmimeve për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut si dhe taksat e Kyçjes”

6.b.iii. Nuk është krijuar ende, mbetet peng i mos zbatimit të Marrëveshjes për Kycje KOSTT-ENTSOE, si pasojë e obstrukcioneve nga ana e Serbisë. Në Samitin e Parisit të mbajtur më 5 korrik, 2016 për Agjendën e Konektivitetit është rekomanduar si në vijim: të gjitha OST duhet të lejojnë Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) të jetë i lidhur me Rrjetin Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E) dhe alokimin e kapaciteteve në interkonektorët e vendeve fqinje.

Me zbatimin e Marrëveshjes për Kycje KOSTT/ENTSO-E do të funksionalizohet linja e re interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri dhe krijohen hapat e parë për tregun e përbashkët. Për më tepër, si pasojë obstrukcioneve të Serbisë, një masë e madhe e masave të buta mbeten të pa përbushura. Kjo çështje është ngritë si problematike disa herë drejt Komisionit Evropian, Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore dhe Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (ENTSO-E). Në tentim të zgjidhjes së kësaj çështje, Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në takimin e mbajtur më 14 tetor 2016, në bazë të ankesës nga KOSTT ndaj Serbisë në rastin ECS-3/2008, konfirmohet që Serbia ka shkelur Traktatin e Komunitetit të Energjisë, respektivisht, nenin 3 dhe 6 të Rregullores së KE-së 1228/2003 dhe ka marrë vendim me të cilin e obligon Republikën e Serbisë që deri me datën 31 Dhjetor 2016 të merr masat në eliminimin e shkeljeve të konstatuara dhe të përbush kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Për më tepër, moszbatimi i marrëveshjes nga ana e Serbisë është duke paraqitur pengesa për Kosovën edhe në kuadër të bashkëpunimit rajonal në fushën e infrastrukturës, veçanërisht në nismën e WB6 që ndër të tjera kërkon ndërlidhjen rajonale në sektorin e energjisë

6.b.iv. KOSTT është në bashkëpunim të ngushtë me OST Shqipëri sa i përket aktiviteteve përgaditore për krijimin e bursës shqiptare të energjisë APEX, në mënyrë që KOSTT të jetë e gatshme për përfshirje në APEX që nga themelimi. Për këtë qëllim një numër në përmirësimin e kuadrit ligjor/ rregullativ janë në proces dhe duhet të përshateten në mënyrë që kjo të bëhet e mundur. Edhe në këtë rast Marrëveshja për Kycje KOSTT –ENTSO-E duhet të jetë në fuqi.

6.b.v. Aktualisht janë tre furnizues KESCO, HEP dhe GSA, ndërsa edhe një aplikacion është në proces të vlerësimit në ZRRE.

6.b.vi. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes për Kycje ndërmjet ENTSO-E-së dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A. (KOSTT) të Kosovës ende nuk ka ndodhur. Ky proces është vonuar për shkak se Serbia (EMS) nuk ka përbushur detyrimin e vet nga kjo Marrëveshje (KOSTT më 1 tetor 2015 ka nënshkruar Marrëveshjen për Kycje me ENTSO-E me kushtin për implementimin e saj e imponuar nga EMS për licencimin e kompanisë serbe për furnizim "Elektrosever" në veri të Kosovës.) Prandaj presim që të gjitha palët, përfshirë Komisionin Evropian, SKE (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë) dhe posaçërisht ENTSO-E që të mbështesin futjen në opërim të Marrëveshjes, në mënyrë që të shmangen vonesa të mëtejshme në zbatim, pasi që kjo do të dekurajojë dhe parandalojë zhvillimin e sektorit të energjisë në Kosovë, si dhe pamundëson zhvillimin drejt liberalizimit të tregut, hapjes së tregut dhe iniciativat për zhvillimin e tregut të lirë në nivel kombëtar dhe rajonal

6.b.vii. Aktualisht KOSTT ka kodet e rrjetit me të cilat opëron Sistemin Transmetues. Këto kode janë në përputhje të plotë me Manualin e Opërimit të ENTSO-E.

Kodet e reja aktualisht janë obligative vetëm për anëtarët e BE. SKE ka filluar procesin e ashtuquajtur të implementimit të hershëm të këtyre kodeve edhe në vendet e EJT që janë nënshkruese të Traktatit. KOSTT është duke bashkëpunuar me SKE dhe sipas agjendës së implementimit në këtë regjion edhe KOSTT do të bëjë të mundur harmonizimin dhe implementimin e tyre. Këto kode, një pjesë e tyre ende nuk janë në fuqi edhe në vendet e BE. Disa prej tyre priten të hyjnë në fuqi në vitet në vijim. Megjithatë KOSTT ka përshtatur kodet ekzistuese për disa kode që janë shumë të rëndësishme për zhvillimet aktuale. Aktualisht, konform dispozitave që dalin nga Kodi i Rrjetit të ENTSO-E, KOSTT ka: a) përgatitur Kodin për Stacionet Gjeneruese të Energjisë Solare, b) ka përshtatur Kodin ekzistues të Stacioneve Gjeneruese të Energjisë me Erë, c) sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit të ENTSO-E ka përshtatur disa dispozita që ndërlidhen me konditat operative të sistemit në nënkodet tjera të Kodit të Rrjetit. Këto dokumente të përgatitura/përshtatura do të dërgohen në ZRRE për aprovim.

TRANSPORTI

6.b.1. Tregu i transportit në Kosovë është i hapur, këtë e vertetojnë edhe legjislacioni primar dhe sekondar aktual i Kosovës. Ajo që Ministria e Infrastruktues është e angazhuar aktualisht në këtë fushë është niveli sa më i lartë i sigurisë në transport. Kosova sa i përket transportit hekurudhor e ka të hapur tregun e transportit dhe secili operator i transportit hekurudhor e ka të drejtën e qasjes në rrjetin hekurudhor nëse i njëjti i plotëson kriteret e parapara me ligj. Ligji nr.04/L-179 për transportin rrugor dhe legjislacioni sekondar që derivon nga ky ligj. Po ashtu, është bërë rregullimi dhe zhvillimi sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, qasjen e hapur dhe jodiskriminuese për të gjithë operatorët që pretendojnë të ushtrjnë veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave për të gjithë operatorët resident dhe jo resident.

6.b.1.1. Kosova merr pjesë aktive në zbatimin e reformave hekurudhore në kuadër të SEETO-s së bashku me vendet tjera të Ballkanit Përqendror, duke e zbatuar Planin e Menaxhimit të Masave të Reformave të Konektivitetit. Shumë masa janë realizuar, ndërsa një numër i tyre është në zhvillim e sipër nën mbështetjen e ekspertëve të angazhuar nga Komisioni Evropian.

6.b.2. Sa i përket hekurudhave, Kosova ka bërë hapjen e tregut hekurudhor për operatorët tjerë të transportit në drejtim të rritjes së konkurrencës në transportin hekurudhor. Për këtë arsye, në vitin 2016 është bërë licencimi, certifikimi dhe futja në tregun hekurudhor të transportit të një operatori privat të transportit hekurudhor të mallrave.

Ligji për transportin rrugor përcakton konturat themelore të rregullimit të sektorit të transportit i cili garanton një sistem funksional sa i përket konkurrencës së tregut të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave duke krijuar një treg liberal dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët resident dhe jo resident.

6.b.2.1. Edhe përkundër ndryshimeve në legjislacion, masave të ndërmarra në organizmin e provimit për patentë shofer, dhe masat tjera në kuadër të MI-së, kjo objektivë nuk është arritur.

Deri në vitin 2016 ka pasur një trend më pozitiv, ndërsa viti 2017 ky trend pozitiv ka pasur një kthesë negative, sidomos gjatë periudhës Qershor-Gusht 2017. Më poshtë gjeni krahasimin në shifra dhe përqindje për vitin 2014 dhe 2016 dhe periudhën Janar-Korrik 2014 me periudhën Janar-Korrik 2017.

Në vitin 2014 kemi gjithsej 109 aksidente me fatalitet, ndërsa në vitin 2016 kemi 99 aksidente me fatalitet, në vitin 2016 kemi një rënie të aksidenteve me fatalitet për -9.17%. Në vitin 2014 kemi gjithsej 124 persona të vdekur në trafikun rrugor, ndërsa në vitin 2016 kemi 110, në vitin 2016 kemi një rënie të aksidenteve me persona të vdekur për -11.29%.

Kemi gjithsej 64, në vitin 2017 kemi një ngritje të aksidenteve me fatalitet për +4.91%. Në periudhën Janar-Korrik të vitit 2014 persona të vdekur në trafikun rrugor kishim gjithsej 72, në vitin 2017 numëri është 70, në vitin 2017 kemi një rënie të aksidenteve me persona të vdekur për -2.72%.

6.b.2.2. Nuk ka informacione

6.b.2.3. Për sa i përket vendosjes së sistemit inteligjent të transportit (SIT) në Rrjetin Kryesor, është duke u përgatitur plani i vendosjes së instalimeve të ITS në rrjetin kryesor të transportit (autostrada 6,7 dhe rruga nacionale N2 dhe N9).

6.b.2.4. Nuk ka informacione

6.b.2.3. Nuk ka informacione

6.b.3.1. Sa i përket hekurudhave Kosova ka bërë nënshkrimin e marrëveshjes mbi kalimin hekurudhor kufitar me Maqedoninë e cila është nënshkruar në vitin 2011, por zbatimi i saj akoma nuk ka filluar për shkak të ngecjes së nënshkrimit të nënmarrëveshjeve të policive kufitare, doganave, institucioneve fito sanitare, etj.

Me datën 10 shkurt 2017 në BONN të Gjermanisë është mbajtur takimi I komisioneve teknike ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë me këtë rast ka nënshkruar protokolin teknik mbi fushën e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet dy vendeve, cili hapë mundsinë e qasjes së operatorëve të transportit të të dy vendeve respective në tregun e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave. me 30 maj ne Plave te Malit te Zi është nënshkruar Protokollin për themelimin e Qendrës së përbashkët tre-laterale Kosovë-Shqipëri-Mal i Zi.

6.b.3.2. Është bërë rishikimi i planit të veprimit të Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit

Gjendja për periudhën K3– K4

a1) Qeveria ka publikuar 3 raporte për klauzolen e investimeve, raportin e parë në Mars të 2016, raportin e dytë në Qershor të 2016 dhe raportin e tretë në Mars të 2018.

a2) Nga shtatori deri në dhjetor 2017, Qeveria e Kosovës ka negociuar me sukses kredinë e parë të projektit nga Kijeva deri në Zahaq, i cili është pjesë e rrjetit gjithëpërfshirës të Agjendës së Konektivitetit. Projekti përfshin 32 km dhe planifikohet të financohet nga kreditë në shumë prej 151 milionë eurosh. Kredia e parë u nënshkrua me BERZH-in në dhjetor 2017 dhe është në shumë prej 71 milionë eurosh. Qeveria aktualisht është duke negociuar me BEI-në për marrëveshjen e dytë financuese prej 80 milionësh, e cila pritet të nënshkruhet deri në prill 2018.

ENERGJIA

6.b.iii. / 6.b. iv. - Me datën 27 Nëntor 2017 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës si dhe ndërmjet operatorëve: Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu sh.a. (KOSTT) Dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST) për krijimin e bursës shqiptare të energjisë. Aksionar i Tregut të përbashkët Kosovë –Shqipëri do të jetë OST dhe KOSTT. Opërimi i bursës së energjisë për zonën tregtare të Kosovës është ngushtë i lidhur me implementimin e Marrëveshjes për Kycje KOSTT – ENTSO-E

6.b.vi. Nuk ka ndonjë zhvillim të theksuar nga 6 muhori i parë.

6.b.vii. I vetmi ndryshim nga 6 muhori i parë është dergimi për aprovim i dokumenteve të poshtshenuara në ZRrE:

- a) Kodin për Stacionet Gjeneruese të Energjisë Solare,
- b) Ndryshimet në Kodin ekzistues të Stacioneve Gjeneruese të Energjisë me Erë,
- c) sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit të ENTSO-E ka përshtatur disa dispozita që ndërlidhen me konditat operative të sistemit në nënkodet tjera të Kodit të Rrjetit.

TRANSPORTI

6.b.1. Tregu i transportit në Kosovë është i hapur, këtë e vertetojnë edhe legjislacioni primar dhe sekondar aktual i Kosovës. Ajo që Ministria e Infrastruktues është e angazhuar aktualisht në këtë fushë është niveli sa më i lartë i sigurisë në transport.

6.b.1.1. Kosova ka hapur tregun hekurudhor për të gjitha ndërmarrjet hekurudhore (Opërorët Hekurudhor). Opërori Hekurudhor privat "RAILTRANS" është licencuar dhe certifikuar nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave. Menaxheri i Infrastrukturës INFRAKOS ka nënshkruar Marrëveshjen e Qasjes në Hekurudhë me RAILTRANS. Kompania në fjalë tashmë është funksionale dhe ka filluar opërimet me transport të mallrave.

6.b.2. Bazuar në të dhënat statistikore deri më tani për këtë vit gjendja është përkeqësuar pasi që të dhënat tregojnë se kemi një rritje të aksidenteve me fatalitet dhe është rritur edhe numri i personave të vdekur, kjo çështje duhet të adresohet sa më parë.

6.b.2.1. Sfidë të vazhdueshme paraqet niveli i lartë i aksidenteve në komunikacionin rrugor, me theks të veçantë aksidentet me fatalitet ku pësojnë këmbësorët. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së pjesëmarrësve në komunikacion janë realizuar pesë projekte.

Projektet e realizuara: Me moton: “Rruga e sigurtë – Ndalo, Shiko, Vëzhgo, Lëviz”, të cilat krahas ligjëratave në shkollat fillore janë shpërndarë 180.000 fletëpalosje, në tërë vendin. Në vitin 2017 janë realizuar tri spote televizive me mesazh vetëdijësues për sigurinë në trafikun rrugor, “Përdorimi i rripit të sigurisë”, “Kujdesi ndaj shpejtësisë së levizjes” dhe “Kujdesi për përdorimin e kufjeve”. Po ashtu, si pjesë e projekteve për siguri rrugore në 7 regionet e Kosovës janë realizuar 7000 anketime për përdorimin e “Rripit të sigurisë” dhe “Përdorimit të ulësve për femijë” si dhe projekti me moton “Ec Sigurtë – Vozit ngadalë, mbërrin më shpejtë”, i cili është realizuar me nxënësit e shkollave të mesme të regjioneve të Kosovës. Pritet që UA për inspektimin e sigurisë rrugore, të vendoset në Planin Legjislativ 2018.

6.b.2.2. Në lidhje me lehtësimin e tregtisë ndërmjet vendeve të CEFTA-s, Kosova ka negociuar Protokollin Shtesë 5 për lehtësimin e tregtisë, është paraparë të miratohet në gjysmën e parë të vitit 2017. Që nënkupton se nuk është ratifikuar ende. Qëllimi i këtij protokoll është thjeshtëzimi, harmonizimi dhe standardizimi i procedurave doganore ndërmjet vendeve të CEFTA-s. Plani i Veprimit që del nga Protokollin i V-të tashmë është finalizuar për gjithë rajonin e BP dhe masat e parapara për zbatim janë dakorduar mes vendeve të BP janë të përfshira në Hapësirën Regionale Ekonomike.

Republika e Kosovës, kohë më parë është antarsuar në Organizatën Botërore të Doganave. Ky antarsim do të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin e Doganave të Kosovës, duke përfituar nga disa instrumente në çështjet si klasifikimi i mallrave, rregullat e origjinës, vlersimi, facilitimi i tregtisë, aktivitetet e aplikimit të doganave, promovim të integritetit, ndërtim të kapaciteteve, etj.

6.b.2.3. Draftimi i planit të veprimit për periudhën 2019-2023 për Sistemin Inteligent të Transportit (ITS) është ende çështje diskutimi me Connecta-në. Kjo pasi që realizohet me përkrahje të saj.

6.b.2.4. Sa i përket krijimit të një sistemi funksional të mirëmbajtjes ku nuk duhet të ketë seksione në gjendje të keqe dhe shumë të keqe **pritet** që gjithashtu me ndihmën e Konsulencës të angazhuar në projektin CONNECTA (Agjenda e Konektivitetit) të bëhet vlerësimi i gjendjes aktuale të rrjetit rrugorë dhe hekurudhorë dhe të krijohet një bazë e shënimeve e cila do të përdoret për vlerësimin e gjendjes dhe përgatitjen e planit të veprimit për periudhën 2019-2023 për Mirëmbajtjen e Rrjetit Bërthamë dhe Gjithëpërfshirës të SEETO's (Observatori i Transportit për Evropën Jugë – Lindore) që kalojnë nëpër Kosovë (auto-udhët Rruga R6 Prishtinë – Hani i Elezit dhe R7 Merdare - Morinë) dhe për Korridorin X hekurudhor Hani i Elezit - Leshak.

6.b.3. Ngritja e efikasitetit në pikat e kalimit kufitar është process në vazhdimësi ku gjatë kësaj periudhe raportuese policia kufitare dhe agjencionet e tjera të përfshira në menaxhimin e kufirit kanë ndjekur një sërë trajnimesh dhe janë siguruar pajisje dhe është avancuar infrastruktura në PKK.

6.b.3.1. Nuk ka ndonjë ndryshim nga raporti paraprak.

6.b.3.2. Plan i veprimit të strategjisë për menaxhimin e integruar të kufirit është rishikuar vitin e kaluar. Në vitin 2018 është planifikuar hatimi i strategjisë së re dhe planit të veprimit për menaxhimin e integruar të kufirit 2019 – 2024.

2.7	<p>Rritja e sigurisë së energjisë dhe miratimi i strategjisë gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2017-2026</p> <p>a. Vendosja për modalitetet e pronësisë për Kosova B dhe për investimet e reja në gjenerimin e energjisë, dhe dekomisionimi i Kosova A</p> <p>b. Miratimi i Planit të Veprimit të përditësuar mbi burimet e ripërtërishme</p> <p>c. Vlerësimi i modaliteteve më të mira për krijimin e mekanizmit për financimin e eficientës së energjisë dhe masat mjedisore në sektorin publik dhe atë të rezidencial, dhe nxitja e përdorimit të plotë të iniciativave ekzistuese siç është Programi Rajonal për Eficientë</p>	7. Miratimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të energjisë për periudhën 2016-2025 e cila është në përputhje me standardet mjedisore dhe sociale të BE-së	7. K4 2016	MZHE MMPH	7) Pjesërisht e plotësuar	7) E plotësuar
		7.a. i. Vendimet për modalitetet e pronësisë së Kosova B, të marra;	7.a.i. K4 2017		7ai) Në realizim e sipër	7ai) E plotësuar
		7.a.ii. Investimet e reja në gjenerimin e energjisë (të gjitha burimet);	7.a.ii. K4 2017		7aii) Në realizim e sipër	7) Pjesërisht e plotësuar
		7.a.iii. Afati i fundit për dekomisionimin e Kosovës A, të jetë fiks;	7.a.iii. K1 2017		7aiii) E plotësuar	
		7.b.i. Raporti i dytë mbi ecurinë e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për BRE, i përgatitur;	7.b.i. K1 2017		7bi) E plotësuar	
		7.b.ii. Miratimi i planit për burimet e ripërtërishme, i përditësuar, duke përfshirë masat e duhura për të siguruar që Kosova po arrin 25% të objektivave të energjisë së ripërtërishme në vitin 2020;	7.b.ii. K3 2017		7bii) Në realizim e sipër	7bii) Pjesërisht e plotësuar
		7.c.i. Misioni i TAIEX për të vlerësuar modalitetet e mekanizmit të financimit për eficientën e energjisë dhe masat e marra mjedisore;	7.c.i. K1 2017		7ci) E plotësuar	
		7.c.ii. Vlerësimi dhe marrja e vendimeve për modalitetet e mekanizmit të financimit për të mbështetur investimet në eficientën e energjisë dhe mjedisit;	7.c.ii. K3 2017		7cii) Në realizim e sipër	7cii) Pjesërisht e plotësuar
		7.c.iii. Miratimi i planit të veprimit 2016-2018 mbi eficientën e energjisë;	7.c.iii. K4 2016		7ciii) Pjesërisht e plotësuar	7ciii) E plotësuar
		7.c.iv. Miratimi i ligjit mbi performancën e energjisë në	7.c.iv. K4			

	ndërtesa; 7.c.v. Miratimi i legjislacionit sekondar, që transponon Direktivën 2010/31/EU nëpërmjet	2016 7.c.v. K2 2017		7civ) E plotësuar
	a) Rregullore për përcaktimin e performancës minimale të energjisë në ndërtesat e reja të banimit, ndërtesat nën renovim dhe llojet e tjera të ndërtesave të banimit,			a) Pjesërisht e plotësuar
	b) Rregullore për certifikatën e performancës së energjisë për ndërtesat e reja dhe ndërtesave të tjera			b) Pjesërisht e plotësuar
	c) Rregullore për inspektimin e sistemit të ngrohjes dhe pajisjeve për kondicionimin e ajrit;			c) Pjesërisht e plotësuar

Gjendja për periudhën K1– K2

7.Me 7 prill 2017 është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026. Dokumenti është proceduar në Kuvendin e Kosoves por siç dihet Kuvendi është shpërbërë dhe tash dokumenti duhet të rishtohet sërish dhe të dërgohet për aprovim, në Qeverinë e re pas konstituimit. Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2017-2019 përgatitet pas miratimit të Strategjisë së Energjisë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

7.a.i. Tashmë është finalizuar studimi i I fizibilitetit për implementimin e masave mjedisore në TC Kosova B. Me finalizimin e studimit të dytë për modalitetet e financimit që pritet se shpejti të përfundoj, Qeveria e Republikës së Kosovës do të marrë vendim rreth modalitetit të implementimit të masave mjedisore në TC Kosova B në të ardhmen që mund të ndikoj edhe në elementin e pronësisë së saj.

7.a.ii. E paraparë të realizohet në K4 2017.

7.a.iii. Në bazë të Strategjisë së Energjisë 2017-2026 afati I mbylles se TC Kosova A është viti 2023 pas fillimit të punës së TC Kosova e Re.

7.b.i. Raporti i dytë i progresit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për BRE është dorëzuar në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë me 30 Dhjetor 2016.

7.b.ii. Ka vazhduar aktiviteti për rishikimin e Planit Kombëtar të Veprimit për BRE me konsulencën e KE në kuadër të projektit të IPA-s për EE dhe BRE. Aktiviteti planifikohet të realizohet në periudhën K4 në harmoni me afatet kohore në dokumentin PKZMSA-së dhe me dokumentin e ERA.

7.c.i. Janë realizuar dy misione të ekspertëve të përkrahur nga TAIEX lidhur me vlerësimin e modaliteteve për zgjedhjen e një mekanizmi për vjeljen e taksave mjedisore që do të shërbenin për financimin e projekteve mjedisore dhe të efikasitetit të energjisë. Misioni i parë është realizuar në mars 2017 dhe i dyti është realizuar nga data 28.08 gjerë me 01. 09.2017. janë nxjerrë rekomandimet

7.c.ii. Vendimin duhet ta marrë Qeveria pas propozimit të njerës nga modalitetet. E paraparë të kompletëhet në K3 2017.

7.c.iii. Plani i tretë i veprimit për efikasitet të energjisë 2016-2018 është dërguar për miratim në Qeveri.

7.c.iv. Ligji është miratuar dhe është publikuar në gazet zyrtare, me datë 22.10.2016.

Ky Ligj ka për qëllim të promovojë përmirësimin e performancës energjetike në ndërtesa, duke marrë parasysh kushtet e jashtme dhe lokale klimatike, si dhe kërkesat për klimën e brendshme dhe koston efektive. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Direktivën nr.2010/31 të BE-së për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe Direktivën 2012/27/të BE-së e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për efikasitetin e energjisë.

a) Kjo Rregullore është draftuar, por janë verejtur shumë mangësi dhe e njajta do të plotësohet në përkrahje të Projektit të ri Regional REEP + i përkrahur nga BERZH -i.

b) Rregullorja është finalizuar dhe është në fazën e diskutimit publik.

c) Rregullorja është finalizuar dhe është në fazën e diskutimit publik.

Gjendja për periudhën K3– K4

6. Strategjia e Energjisë 2017-2026 është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me date 06.10.2017, ndërsa, nga Kuvendi është miratuar me datë 26.01.2018.

7ai. Me date 20.10.2016 është marrë vendimi mbi pronësinë e TC Kosova B, përmes të cilit TC Kosova B do të jetë në pronësi publike (së paku 51% të aksioneve) për 10 vitet e ardhshme.

7aii. Janë instaluar 6 Hidrocentrale me kapacitet total prej 30.5 MW (duke përfshirë HC Brezovica që filloi punën me 19 Prill 2017 me kapacitet të instaluar prej 2.1 MW). Ndërsa, sa i përket energjisë diellore, dy panele fotovoltaike (9.4 MW). Në kuadër të burimi tjetër të energjisë – erës një (1) mulli ere %shtë në punë me kapacitet 1.35 MW dhe nj (1) autorizim përfundimtar është lëshuar me kapacitet prej 32.4 Mw).

7bii. Është draftuar rishikimi i Planit Kombëtar të Veprimit dh është komentuar nga palët e kyçura në process. Dokumenti është dërguar për opinion në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Plani i rishikuar pritet të miratohet në fund të periudhës K1 2018.

7cii. Aplikacioni për përkrahje ë TAIEX është miratuar dhe është mbajtur misioni i parë me ekspert të BE-së në Mars 2017, dhe misioni i dytë në muajin Gusht. Nga të gjeturat e ekspertit mbi modalitetet e mundëshme për themelimin e fondit është përgaditur rekomandimi.

7ciii. Plani i Veprimit 2016 – 2018 mbi efikasitetin e Energjisë është miratuar me 02.08.2017 dhe është dërguar në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

7cva. Për shkak të ndryshimit të legjisllacionit të BE-së, ky draft do të rihartohet me përkrahje të BERZH me projektin REEP – plus.

7cvb. Drafti i Rregullores është finalizuar plotësisht, ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit dhe ka marrë opinionin ligjor. Është në pritje të miratimit nga Ministria.

7cvc. Draft ii Rregullores është finalizuar plotësisht, ka kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit, diskutimit publik dhe ka marrë opinionin ligjor. Është në pritje të miratimit nga Ministria.

III. PUNËSIMI DHE ARSIMI

3.1	Miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Sektoriale për Punësimin dhe Politikën Sociale 2015-2020 dhe miratimi i Planit të Veprimit 2017-2018 për zbatimin e strategjisë	<p>1. Strategjia Sektoriale është hartuar dhe konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve;</p> <p>2. Strategjia Sektoriale dhe Plani i saj i Veprimit, të miratuara.</p> <p>3. Buxheti për zbatimin e strategjisë është ndarë.</p>	<p>1. K4 2016</p> <p>2. K2 2017</p>	MPMS MKRS MASHT	1) E plotësuar	
					2) Pjesërisht e plotësuar	2) E paplotësuar
					3) E paplotësuar	

Gjendja për periudhën K1– K2

- Grupet punuese të MPMS të asistuar edhe nga projekti KEEN, kanë përgatitur dhe finalizuar draftin e Strategjisë Sektoriale dhe Planin e Veprimit. Deri në finalizimin e tyre është përdorur qasje e kombinuar e punës të formatit të takimeve interne të grupit drejtues dhe grupeve tematike, si dhe formatit me të gjërë përmes të workshopeve, ku janë përfshirë edhe akter të tjerë. Pas finalizimit Strategjia dhe Plani i Veprimit, janë dërguar për konsultime të donatorët dhe partnerët e ministrisë;
- Strategjia dhe plani i veprimit janë hartuar sipas kërkesave formale dhe administrative të ZKM, po ashtu është respektuar koncepti i integruar i planifikimit strategjik. Strategjia Sektoriale dhe Plani i Veprimit janë në proces të konsultimit sipas rregullores së qeverisë, ku pastaj do të dërgohet për miratim nga qeveria;
- Përderisa nuk është miratuar strategjia nuk mund të bëhet ndarja e buxhetit.

Gjendja për periudhën K3– K4

2/3. Pritet miratimi i Strategjisë nga Qeveria.

3.2	a) Krijimi i një plani të veprimit për trajtimin papunësisë tek të rinjtë në bazë të një vlerësimi të sfidave dhe duke u fokusuar në përmirësimin e rezultateve të arsimit dhe mbështetjen e kalimit nga shkolla në punë	a.1 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është hartuar	a.1 K4 2016	MPMS	a 1) E plotësuar	
		a.2 Draft Plani i veprimit është konsultuar me akterët përkatës, përfshirë komunitetin e donatorëve	a.2 K1 2017		a2) Pjesërisht e plotësuar	a2) E plotësuar
		a.3 Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, është miratuar	a.3 K1 2017		a3) E paplotësuar	a3) E plotësuar

	b) Ndërmarrja e masave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës	b.1 Rritet asistenca e pranuar nga gratë nga shërbimi i punësimit	b.1 K1 2017		b1) Pjesërisht e plotësuar	
		b.2 Draft analiza e pengesave në punësimin e femrave është bërë në konsultime me akterët relevant	b.2 K2 2017		b2) Nuk ka informata.	b2) Pjesërisht e plotësuar
		b.3 Përdorimi i analizës për zhvillimin e masave të duhura për përmirësimin e papunësisë së grave	b.3 K3 2017		b3) Në realizim e sipër	b3) Pjesërisht e plotësuar

Gjendja për periudhën K1- K2

- a.1) Është hartuar Plani i Veprimit për punësimin e të rinjve.
- a.2) Drafti final i Planit të Veprimit për Adresimin e Papunësisë së të Rinjëve është shpërndarë tek donatorët për komente;
- a.3) Plani i veprimit me tregues të qartë për trajtimin e papunësisë tek të rinjtë, nuk është miratuar ende.
- b.1) Gjatë periudhës prill-qershor, në tregun e punës janë ndërmjetësuar 233 femra;
- b.2) Nuk ka informacione për këtë aktivitet
- b.3) E paraparë të plotësohet në K3 2017.

Gjendja për periudhën K3- K4

- a.2/2.3) Planit të Veprimit për Adresimin e Papunësisë së të Rinjëve është miratuar nga Qeveria me 4 Janar 2018.
- b.1/b.2/b.3) Koorporata e Sfidave të Mijëvjeçarit (MSS), ka bërë një hulumtim nacional për përdorimin e kohës dhe papunësisë, ku përfshihet edhe çështja e papunësisë së grave. Rezultatet e këtij hulumtimi do të përdoren nga MPMS, për hartimin e plotikave të punësimit dhe aftësimin profesional.

3.3	Sigurimi i zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit, në veçanti nëpërmjet funksionalizimit të agjencisë për punësim dhe ndarjes së buxhetit të nevojshëm për të siguruar që është në gjendje të iniciojë masat aktive të tregut të punës me rezultate të prekshme.	1. Realizimi i një vlerësim të nevojave të tregut të punës (përfshirë mbi AAP)	1. K1 2017	MPMS	I. Pjesërisht e plotësuar
		2. Përzgjedhja e Drejtorit të Agjencisë së Punësimit dhe Bordit Këshillues është përfunduar dhe rregulloret e punës për Agjencinë e Punësimit janë miratuar;	2. K4 2016		2. Pjesërisht e plotësuar
		3. Masat aktive të tregut të punës janë zbatuar nga Agjencia e Punësimit (thirrjet për aplikime janë lansuar, mbështetja financiare është dhënë sipas rezultateve të thirrjeve);	3. K2 2017		3. E plotësuar

Gjendja për periudhën K1– K2

1. Është vendosur një aktivitetet për realizimin e një hulumtimi lidhur me “Analizën e nevojave të tregut të punës”. Në këtë kontekst, Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB), ka kryer një hulumtim në teren dhe aktualisht është duke i përpunuar këto të dhëna, për të nxjerrë një draft raport;
2. Drejtori i Përgjithshëm është zgjedhur, ndërsa për zgjedhjen e Bordit Këshilldhënës ende nuk ka filluar procesi; Pas zgjedhjes dhe funksionalizimit të Bordit këshilldhënës të APRK-se, do të hartohet rregullorja për Bordin Këshilldhënës;
3. Gjatë periudhës prill - qershor, në punësim janë ndermjetësuar 605 persona, prej tyre 233 femra dhe 372 meshkuj;

Gjendja për periudhën K3– K4

1. Është përfunduar vlerësimi i nevojave të tregut të punës i cili do të përdoret për qëllimet e definuara në pikën e sigurimit të zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit.
3. Nga Qeveria është nxjerrë vendimi përmes të cilit janë emëruar anëtarët e Bordit Këshilldhënës të Agjencisë së punësimit. Tash pritet hartimi i rregullores.

3.4	Miratimi i legjislacionit të mbetur që ofron bazën për reforma të politikave në sektorin e arsimit	1. Projektligji i rishikuar mbi arsimin e lartë, i miratuar;	1. K1 2017	MASHT	1) E paplotësuar	2) Pjesërisht e plotësuar
		2. Projektligji mbi profesionet e rregulluara në Kosovë, është miratuar;	2. K2 2017		2) E plotësuar	
		3. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017/2021 është miratuar nga qeveria dhe është ndarë buxheti i nevojshëm për të siguruar zbatimin e tij;	3. K4 2016		3) E paplotësuar	3) Pjesërisht e plotësuar
Gjendja për periudhën K1– K2						
<p>1. Projektligji i rishikuar ende nuk është miratuar.</p> <p>2. Projektligji për profesionet e rregulluara i miratuar – projektligji është miratuar nga Kuvendi në Nëntor të 2016.</p> <p>3. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017/2021 - Mbulimi i gapit financiar- Pritet të shqyrtohet kërkesat e reja me Rishikimin e buxhetit</p>						
Gjendja për periudhën K3– K4						
<p>1. Ligji për Arsimin e Lartë është tërhequr nga Kuvendi për arsye politike. Është themeluar Grupi punues i cili është duke hartuar draft ligjin. Draft ligji pritet të procedohet në qeveri deri në fund të Janarit.</p> <p>3. Nuk është siguruar ende buxheti shtesë. Pritet që MASHT dhe MF të organizojnë një konferencë me donator për të shqyrtuar mundësinë e burimit financiar.</p>						
3.5	Përmirësimi i cilësisë së arsimit nëpërmjet:	a.1 Numri i objekteve publike për kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është rritur	a.1. K3 2017	MASHT	a.1) Në realizim e sipër	a.1) Pjesërisht e plotësuar
		b.1. Kurrikula bërthamë për arsimin parashkollor është zhvilluar dhe ka filluar faza e saj e pilotimit	b.1. K4 2017		b.1) Në realizim e sipër	b.1) Pjesërisht e plotësuar
		b.2 Korniza e Kurrikulës Bërthamë e Arsimit Para-universitar (i vitit 2011 dhe 2012) është shqyrtuar dhe aprovuar dhe rezultatet e të nxëniet për lëndët dhe klasat është janë zhvilluar në shkolla;	b.2. K2 2017		b.2) E plotësuar	

<p>mësimdhënësve.</p> <p>d. Përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të arsimit të lartë</p> <p>e. Nxitja e lidhjeve më të mira ndërmjet arsimit të lartë dhe tregut të punës nëpërmjet lehtësimit dhe nxitjes së themelimit të bordeve industriale në universitete të cilat këshillojnë IAL-të mbi rëndësinë e kurrikulave mësimore, identifikimi i mangësive në shkathhtësitë e të diplomuarve, pjesëmarrja në trajnim dhe mësimdhënie (vizita, seminare) dhe ofrimi i trajnimeve dhe përvojë në punë praktike për studentët</p>	<p>b.3 Korniza e Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Para-Universitar dhe syllabusi për klasat dhe lëndët është shqyrtuar dhe aprovuar me zbatimin të mëposhëm në të gjitha shkollat, duke filluar nga viti shkollor 2017/2018;</p>	<p>b.3. K4 2017</p>		<p>b.1) Pjesërisht e plotësuar</p>	<p>b.1) Pjesërisht e plotësuar</p>
	<p>c.1. Mekanizmat për sigurimin e cilësisë të zhvilluara përmes emërimit të koordinatorëve të cilësisë në shkolla dhe krijimit të sistemit efikas për vlerësimin e performancës në shkolla;</p>	<p>c.1. K2 2017</p>		<p>c.1) E paplotësuar</p>	<p>c.1) Pjesërisht e plotësuar</p>
	<p>c.2. Agjencia për Kurrikulë, Standarde dhe Vlerësim është themeluar dhe është plotësisht funksionale;</p>	<p>c.2. K2 2017</p>		<p>c.2) E paplotësuar</p>	
	<p>c.3. Projektligji i rishikuar mbi inspektoratin e arsimit në Kosovë është miratuar nga Kuvendi dhe inspektorët kanë filluar aktivitetet e tyre, me inspektorë dhe kapacitete të mjaftueshme</p>	<p>c.3. K4 2017</p>		<p>c.3) Në realizim e sipër</p>	<p>c.1) Pjesërisht e plotësuar</p>
	<p>d.1. Krijimi dhe funksionalizimi i Këshillave Industriale</p>	<p>d.1 K2 2017</p>		<p>d.1) E paplotësuar</p>	<p>d1) Pjesërisht e plotësuar</p>
	<p>d.2. Shqyrtimi i programeve studimore dhe politikave të regjistrimit</p>	<p>d.2 K3 2017</p>		<p>d.2) E paplotësuar</p>	
	<p>e.1 Projekt propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në universitete që këshillojnë IAL-të, është prezantuar</p>	<p>e.1 K1 2017</p>		<p>e.1) E paplotësuar</p>	<p>e1) Pjesërisht e plotësuar</p>
	<p>e.2 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitete që këshillojnë IALtë shkon në konsultime publike</p>	<p>e.2 K3 2017</p>		<p>e.2) E paplotësuar</p>	<p>e2) Pjesërisht e plotësuar</p>
	<p>e.3 Propozimi mbi themelimin e bordeve industriale në Universitetet që këshillojnë IALtë është miratuar dhe fillon zbatimin</p>	<p>e.3 K3 2017</p>		<p>e.3) E paplotësuar</p>	<p>e3) Pjesërisht e plotësuar</p>

Gjendja për periudhën K1– K2

a.1. Janë lidhur kontratat dhe kanë filluar punimet për ndërtimin e 3 (tre) kopshteve ndërsa 1 kopsht është në procedurë të lidhjes së kontratës në MAP e cila është bartë me marreveshje MASHT - MAP. Keto 4 qerdhe ndertohen me planifikim të MASHT-it, dhe me buxhet të konsoliduar të Qeverisë së Kosovës (2 qerdhe prej të cilave janë në participim me projektin IPA 2016). Gjithashtu janë në proces të fazës së projekimit edhe 6 kopshte me IPA 2016.

b.1 Është formuar grupi punues për finalizimin e kurrikulës bërthamë për edukim parashkollor 0-5 vjeç. Është hartuar plani i aktiviteteve, të cilat duhet të realizohen për finalizimin e kurrikulës bërthamë për edukim parashkollor. Divizioni për edukim parashkollor, gjatë kësaj periudhe ka organizuar dy punëtori (një punëtori njëditore dhe tjetra tri-ditore) me grupin punues për finalizimin e kurrikulës bërthamë për edukimin parashkollor të moshës 0-5 vjeç.

b.2 Janë të përfunduara, të aprovuara dhe janë në zbatim.

b.3 Janë hartuar programet lëndore për klasën 2, 7, 11 dhe janë në zbatim në 92 shkolla, në vazhdim të vitit shkollor 2017/2018 do të jenë në zbatim në të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës.

c.1 Pritet progres pas fillimit të vitit shkollor 2017/2018.

c.2. Nuk ka asnjë progres

c.3. Eshtë planifikuar buxheti i inspektoriatit si dhe draft plani "Hartimi i kriterëve për Vlerësimin e Përfundimit të Mësimdhënësve (VPM) lidhur me aktivitetet e inspektoriatit të cilat lidhen drejtpërdrejtë me miratimin e këtij ligji. Kjo fillon në proces të zbatimit në Janar 2018 nëse miratohet projektligji deri në fund të vitit 2017.

d.1 / d.2/ e.1/ e.2/ e.3. Nuk ka progres nga raporti i kaluar

Gjendja për periudhën K3– K4

a.1. Nuk ka ndonjë zhvillim nga 6 maji i parë i 2017.

b.1/b.3. Janë nxjerrë udhëzuesit për të gjitha fushat për të ndihmuar zhvillimin e procesit mësimor. Janë hartuar kurrikulat lëndore për klasat 0,1,6,10. Ka filluar zbatimi i tyre dhe MASHT-i është duke i pritë rezultatet e një vlerësimi të bërë nëpër shkolla për të parë se si po ecën zbatimi i kurrikulës.

c.1. Janë emëruar 170 koordinatoret për sigurimin e cilësisë në të gjitha shkollat në vend dhe 24 koordinatoret në nivel të Drejtorive komunale të arsimit. Instituti pedagogjik i Kosovës ka zhvilluar kornizën për sigurimin e cilësisë së performancës në shkolla e cila është miratuar. Është nxjerrë udhëzuesi për vlerësim të brendshëm të mësimdhënësve, i cili ka hyrë në zbatim në shkollat që janë duke implementuar kornizën e kurrikulës së re (71 shkolla). Gjithashtu është përgatitur edhe udhëzimi administrativ për procedurat e vlerësimit të performancës së shkollës, e cila është në proces të miratimit.

c.2. Udhëzimi Administrativ për themelimin dhe funksionimin e Agjencisë është hartuar. Pas diskutimit të kësaj pike nga Këshilli Ministror për Integrim, është vendosur të shikohen mundësitë për krijimin e agjencisë.

c.3. Projektligji ka kaluar në Kuvend, për lexim të parë, me 6 Shkurt 2017.

d.1. Janë krijuar dhe funksionalizuar 7 këshilla industrial, ato kanë mbajtur takimet e para informuese në IAL.

d.2. Duke e ditur që takimet e para kanë qenë informuese atëherë kjo objective konsiderohet e paplotësuar

e.1/e.2/e.3. Rregullorja për themelimin e trupave këshillëdhënës u aprovua nga senati i UP-së në Maj te vitit 2014, ndërsa në nëntor te vitit 2014 kjo rregullore u adaptua në rregullore kornizë e cila do ti ndihmonte njësitë akademike të tjera për t'i themeluar trupat këshillëdhënës. Rregullorja kornizë u aprovua në dhjetor te vitit 2014.

Duhet të miratohen 8 trupa keshilledhense të cilat janë të përfaqësuar nga 27 ndermarrje private dhe 13 shoqata të bizneseve.

3.6	Përmirësimi i cilësisë së Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP) dhe kalimit nga shkolla në punë	a.1 Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës (e bërë në pikën 3.3) përdoret si bazë.	a.1 K1 2017	MASHT KKK Agjencia e Punësimit	a.1) Pjesërisht e plotësuar	
		a.2 Përmirësimi i cilësisë së sistemit të aftësisimit profesional përmes harmonizimit të AAP me nevojat e tregut të punës përmes shqyrtimit të profileve të ofruara në shkollat e AAP-së dhe përafrimit të saj me vlerësimin e nevojave të tregut të punës	a.2 K3 2017		a.2) Në realizim e sipër	a.2) Pjesërisht e plotësuar
		a.3 Hartimi i kurrikulave bërthamë për AAP dhe fillimi i fazës së pilotimit	a.3 K2 2017		a.3) Pjesërisht e plotësuar	
		a.4 Sigurimi i financimit të duhur për qendrat e AAP-së	a.4 K3 2017		a.4) Në realizim e sipër	a.4) E paplotësuar
		b.1 Përmirësimi i rezultateve të arsimit dhe mbështetja e shkollave për kalim në tregun e punës përmes sigurimit të praktikave me punëdhënësit, janë zgjeruar dhe përfshirë në programet studimore	b.1 K3 2017		a.5) Në realizim e sipër	a.5) E paplotësuar

Gjendja për periudhën K1– K2

a.1. Gjithmonë mirret bazë informata nga Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale. Ata kanë vendosur një aktivitetet për realizimin e një hulumtimi lidhur me “Analizën e nevojave të tregut të punës”. Në këtë kontekst, Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB), ka kryer një hulumtim në teren dhe aktualisht është duke i përpunuar këto të dhëna, për të nxjerrë një draft raport;

a.2. Është rishikuar lista e profileve dhe deri në Qershor 40% të tyre janë harmonizuar me tregun e punës përmes të hartimit të standardeve të profesionit.

a.3. Deri me tani janë hartuar 50 standarde të profesionit, 24 profile janë kompletuar me kurrikul te rishikuar, materiale mesimore, pajisje për punëtori.

a.4. E paraparë të realizohet në K3.

b.1. Janë siguruar 6 kompani për bashkëpunim me shkollën për praktiken profesionale dhe është proces i vazhdueshëm.

Gjendja për periudhën K3– K4

a.1. Është përfunduar vlerësimi i nevojave të tregut të punës i cili do të përdoret për qëllimet e definuara në pikën e sigurimit të zbatimit të ligjit mbi agjencinë e punësimit.

a.2/a.3. Është hartuar drafti i parë i Kurrikulës Bërthamë i veçantë për AAP. Ka filluar faza e parë e identifikimit të ekspertëve për procesin e rishikimit të kurrikulave. Janë definuar profilet sektoriale të cilat do të diskutohen me ministritë dhe partnerët relevant.

a.4/b.1. Nuk ka informacione për zhvillimet në 6 mujorin e dytë.

Kjo faqe është lënë qëllimisht e zbrazët

Shënim Politikash

Shënimi i politikave ofron analiza të shkurta, koncize dhe në kohë, mbi çështje të caktuara. Shënimet e Politikave janë raporte të shkurta të cilat përshkruajnë arsyet mbi përzgjedhjen e një alternative të caktuar të politikave mbi një çështje/debat aktual. Ato zakonisht publikohen për një ngjarje të caktuar dhe avokojnë qëndrime profesionale të Grupit për Studime Juridike dhe Politike. Më saktësisht, Shënimet e Politikave janë dokumente avokuese, të cilat ofrojnë argumente lidhur me përshtatjen/ndryshimet e një politike të caktuar. Shënimet e Politikave kanë për qëllim të ndikojnë një audience të synuar mbi rëndësinë/implikimet/zgjidhjet e një problemi aktual dhe me këtë rast sjellin rekomandime tek politikbërësit, shoqëria civil dhe media, dhe publiku i gjërë.



**GROUP FOR LEGAL
AND POLITICAL
STUDIES**

legalpoliticalstudies.org